

MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS

BYROJA E ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



Programi mësimor

GJUHË SHQIPE

për klasën VI

Shkup, 2023

TË DHËNA THEMELORE PËR PROGRAMIN MËSIMOR

Lënda mësimore	Gjuhë shqipe
Lloji/kategoria e lëndës mësimore	E detyrueshme
Klasa	VI (e gjashtë)
Temat/fushat e programit mësimor	<ul style="list-style-type: none"> Gjuhë dhe komunikim Letërsi, të shprehurit dhe krijimtari Njohuri mediatike
Numri i orëve mësimore	4 orë në javë / 144 orë në vit
Pajisjet dhe mjetet	<ul style="list-style-type: none"> Pajisjet teknike në klasë: tabelë elektronike, tabelë e shkollës, teknologji kompjuterike, printer. Mjetet dhe burimet për të mësuar: fotografi, ilustrime me figura që kanë të bëjnë me përmbajtjet dhe veprimtaritë, plakate, afishe letrare, skema dhe paraqitje të ndryshme nga materiali mësimor panele që ndjekin materialin sipas fushave programore, fjalorë, fjalorë drejtshkrimor, leksikon, enciklopedi, libra, programe/software edukative, regjistrime të rrëfimeve, regjistrime audio-vizuale; bibliotekë me libra në klasë, biblioteka e shkollës. <p>Shënim: Nëse mësimi realizohet në kabinet, rekomandohet organizim i një këndi të dramës, një këndi artistiko-letrar, një këndi për gazetari, një vendi të përshtatshëm për bibliotekë në klasë.</p>
Normativi për kuadrin mësimor	<p>Mësimdhënjen e lëndës së gjuhës shqipe në klasën e VI të arsimit fillor nëntëvjeçar mund ta realizojë personi i cili ka kryer drejtimin arsimor të programeve studimore:</p> <ul style="list-style-type: none"> Gjuhë dhe letërsi shqipe - VII/1 ose VI A, 240 kredi* <p>* Sipas Ligjit për mësimdhënës dhe bashkëpunëtorë profesional në shkollat fillore dhe të mesme, Neni 10, paragrafi (3): “Kur në shpalljen publike nga paragrafi (1) i këtij neni, do të paraqiten më shumë kandidatë, përparësi u jepet mësimdhënësve që kanë shkallë më të lartë të arsimit të lartë përkatës dhe sukses më të lartë gjatë studimeve deridiplomike”.</p>

NDËRLIDHJA ME STANDARDET NACIONALE

Rezultatet e të nxënit të dhëna në programin mësimor shpjen në përvetësimin e kompetencave të mëposhtme të përfshira në fushën **Njohuri gjuhësore:**

<i>Nxënësi/nxënësja di dhe mund:</i>	
I-A.1	t'i shprehë dhe t'i transmetojë mendimet, ndjenjat, informacionin dhe qëndrimet e veta në situata të ndryshme komunikimi në gjuhën e vet amtare, nëpërmjet medimeve të ndryshme dhe për qëllime të ndryshme;
I-A.2	t'i njohë e t'i shfrytëzojë format e ndryshme të shprehjes me shkrim: ato letrare (vjersha, tregimi i shkurtër, prezantimi / të folurit, eseja (sprova) letrare, ditari etj.) dhe ato jolettrare (eseja tematike, njoftimi, kërkesa, komunikata, reklama etj.);
I-A.3	të zhvillojë dialog kritik e konstruktiv duke i paraqitur qëndrimet e veta në mënyrë të argumentuar;
I-A.4	të përdorë gjuhën standarde duke iu përmbajtur rregullave gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim;
I-A.6	të identifikojë veçoritë themelore të gjuhës amtare (alfabetin, historinë, dialektet etj.), si dhe ngjashmëritë e dallimet e saj me gjuhët e tjera;
I-A.8	të kuptojë përmbajtjen e mesazheve dëgjimore: të jetë në gjendje t'i shkëpusë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë informacionet nga mesazhet dhe t'i shprehë ato (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.9	të kuptojë përmbajtjen e një teksti të shkruar: të jetë i aftë të veçojë, të analizojë, të vlerësojë dhe të përmbledhë informacionin nga teksti dhe ta shprehë atë (me shkrim dhe me gojë) me fjalët e veta;
I-A.10	t'i kuptojë përmbajtjet e paraqitura vizualisht (diagrame, tabela e grafikë, ilustrime, filma vizatimorë etj.): të jetë në gjendje t'i ndajë, t'i analizojë, t'i vlerësojë dhe t'i përmbledhë përmbajtjet e shfaqura vizualisht dhe t'i sqarojë ato (me shkrim dhe me gojë);
I-A.11	t'i identifikojë e t'i analizojë mesazhet dhe elementet stilistike e estetike të veprave letrare;
I-A.12	të shfrytëzojë informacione nga burime dhe medie të ndryshme dhe t'u qaset atyre në mënyrë kritike, duke marrë parasysh burimin, kontekstin, qëllimin dhe besueshmërinë e informacioneve të paraqitura.
<i>Nxënësi/nxënësja kupton dhe pranon se:</i>	
I-B.1	nëpërmjet mësimin të gjuhës amtare zhvillohet identiteti i vet gjuhësor e kulturor, ndërsa nëpërmjet komunikimit gjuhësor përcillet trashëgimia kulturore dhe kultura e të jetuarit;
I-B.2	me përdorimin e gjuhës në kontekste të ndryshme dhe në forma të ndryshme mundësohet komunikimi dhe ndërveprimi efikas (gjithmonë duke pasur parasysh se me kë bëhet komunikimi);

I-B.4	përmbajtja dhe mënyra e shprehjes së mendimit personal mund të kontribuojë për të mbajtur e për të përmirësuar komunikimin, por edhe të shkaktojnë mosmarrëveshje e konflikte.
I-B.5	leximi dhe të shprehurit në gjuhën amtare janë të rëndësishme për zhvillimin dhe nxitjen e krijimtarisë dhe të të menduarit kritik.

Programi mësimor përfshin edhe kompetencat relevante të këtyre fushave të Standardeve nacionale: **Njohuri digjitale, Zhvillim personal dhe social, Shoqëri dhe kulturë demokratike, Teknikë, teknologji dhe sipërmarrje dhe Të shprehurit artistik dhe kulturë.**

Njohuri digjitale

<i>Nxënësi /nxënësjat dhe mund:</i>	
IV-A.1	të hulumtojë dhe krahasojë mundësitë e pajisjeve digjitale të njohura dhe të reja dhe të vlerësojë, të përzgjedhë dhe të përdorë në mënyrë të pavarur ato që janë më të përshtatshme për një nevojë dhe një situatë konkrete;
IV-A.2	të vlerësojë se për të zgjidhur një detyrë/problem kur dhe si është e nevojshme ta shfrytëzojë TIK-un në mënyrë efektive dhe efikase, të zgjedhë dhe të instalojë programet që i nevojiten, të përdorë programe mbrojtëse dhe të zgjidh problemet rutinë për funksionimin e pajisjeve dhe rrjeteve digjitale;
IV-A.5	të përcaktojë se çfarë informacionesh i duhen që t'i gjejë, t'i përzgjedhë dhe t'i shkarkojë të dhënat, informatat dhe përmbajtjet digjitale dhe të vlerësojë rëndësinë e tyre në raport me kërkesën konkrete dhe besueshmërinë e burimit;
IV-A.7	të zgjedhë e të përdorë mjetet adekuate të TIK-ut për komunikim, të këmbëjë informacione në mënyrë të sigurt, të kontaktojë e të bashkëpunojë me të tjerët në projekte online, në veprimtari sociale ose për nevojat e veta;
IV-A.8	t'i shfrytëzojë në mënyrë të sigurt e me përgjegjësi përmbajtjet digjitale, rrjetet arsimore e sociale dhe format digjitale;
IV-A.9	në komunikimin me të tjerët, në hapësirën digjitale multikulturore, i respekton pjesëmarrësit e ndryshëm dhe ndjek normat ligjore, kulturore dhe etike të sjelljes në hapësirën dixhitale;
IV-A.10	të kujdeset për identitetin, sigurinë dhe reputacionin e vet digjital dhe t'i përfillë politikat rreth privatësisë.
<i>Nxënësi /nxënësjat kupton dhe pranon se:</i>	
IV-B.1	njohuritë digjitale janë të domosdoshme në jetën e përditshme – ato e bëjnë më të lehtë të nxënit, jetën dhe punën, i japin ndihmesë zgjerimit të komunikimit, kreativitetit dhe inovacionit dhe ofrojnë mundësi të ndryshme argëtimi;
IV-B.4	në hapësirën digjitale është e rëndësishme të sigurohet mbrojtja e identitetit, e privatësisë dhe e sigurisë emocionale, të mos përdoret gjuha e urrejtjes e dhuna kibernetike dhe të përfillen rregullat e normat e komunikimit në komunitetet digjitale;
IV-B.5	informacionet e disponueshme në hapësirën digjitale duhet të përdoret në mënyrë etike, sipas rregullave të përcaktuara dhe për të mirën e njerëzve;

Zhvillim personal dhe social

<i>Nxënësi /nxënësjja di dhe mund:</i>	
V-A.4	të bëjë vlerësimin e aftësive dhe arritjeve të veta (duke përfshirë anët e fuqishme dhe anët e dobëta) dhe mbi këtë bazë t'i përcaktojë përparësitë që do t'ia mundësojnë atij / asaj të zhvillohet e të përparojë;
V-A.5	të njohë emocionet te vetvetja dhe te të tjerët, t'i kuptojë pasojat nga reagimet e veta emocionale në situata të ndryshme dhe të përdorë strategji përkatëse për t'u përballur me emocionet;
V-A.6	të përcaktojë qëllime të mesimit e të zhvillimit të vet dhe të punojë për kapërcimin e sfidave që i dalin para në rrugën e arritjes së tyre;
V-A.7	t'i shfrytëzojë përvojat personale për ta lehtësuar mësimnxënien dhe për ta përshtatur sjelljen e vet në të ardhmen;
V-A.8	të organizojë kohën në atë mënyrë që t'i mundësojë atij/asaj, në mënyrë efikase dhe efektive të arrijë qëllimet e përcaktuara dhe të kënaqë nevojat e veta;
V-A.9	të parashikojë pasojat e veprimeve të veta dhe të veprimeve të të tjerëve për veten dhe për të tjerët;
V-A.10	të zbatojë parimet etike për të vlerësuar se ç'është e drejtë dhe ç'është gabuar në veprimet e veta dhe të të tjerëve dhe të manifestojë vetitë e mira të karakterit (të tilla si: ndershmëria, drejtësia, respekti, durimi, kujdesi, mirësjellja, mirënjohja, vendosmëria, guximi dhe vetëdisiplina);
V-A.13	të komunikojë me të tjerët dhe të prezantojë veten në përshtatje me situatën;
V-A.14	të dëgjojë në mënyrë aktive dhe të reagojë në mënyrë adekuate, duke shprehur empati dhe mirëkuptim për të tjerët dhe t'i manifestojë në mënyrë konstruktive shqetësimet dhe nevojat e veta;
V-A.15	të bashkëpunojë me të tjerët për realizimin e qëllimeve të përbashkëta, duke ndarë pikëpamjet dhe nevojat e veta me të tjerët dhe duke i pasur parasysh pikëpamjet dhe nevojat e tjerëve;
V-A.17	të kërkojë informacion prapaveprues (feed back) dhe përkrahje për vete, por edhe të japë informacion prapaveprues konstruktiv dhe përkrahje në dobi të të tjerëve;
V-A.19	të japë propozime, të shqyrtojë mundësi të ndryshme dhe t'i parashikojë pasojat me qëllim që të nxjerrë përfundime dhe të marrë vendime të arsyeshme;
V-A.21	të analizojë, të vlerësojë dhe të përmisojë të nxënësit;
<i>Nxënësi /nxënësjja kupton dhe pranon se:</i>	
V-B.3	arritjet dhe mirëqenia e tij/e saj në masë të madhe varen nga puna që bën ai/ajo dhe nga rezultatet që i arrin ai/ajo;
V-B.4	çdo hap që ndërmerret është me pasojë për të dhe/ose për mjedisin e tij/e saj;
V-B.7	marrja e iniciativës, këmbëngulja, qëndrueshmëria dhe përgjegjësia janë të rëndësishme për zbatimin e detyrave, për arritjen e qëllimeve dhe për kapërcimin e sfidave në situatat e përditshme;

V-B.8	ndërveprimi me të tjerët është i dyanshëm - ashtu si ka të drejtë t'u kërkojë të tjerëve që t'ia mundësojnë atij/asaj t'i përmbushë interesat dhe nevojat e veta, gjithashtu ka edhe përgjegjësi t'u japë hapësirë të tjerëve për të përmbushur interesat dhe nevojat e tij/e saj personale;
V-B.9	kërkimi i informacioneve prapavepruese dhe pranimi i kritikës konstruktive çon drejt përparimit në planin individual dhe shoqëror.

Shoqëri dhe kulturë demokratike

<i>Nxënësi /nxënësjat di dhe mund:</i>	
VI-A.3	t'i formulojë e t'i argumentojë pikëpamjet e veta, t'i dëgjojë me vëmendje e t'i analizojë pikëpamjet e të tjerëve dhe të silltet me respekt ndaj tyre, madje edhe atëherë kur nuk pajtohet me to;
VI-A.5	t'i kuptojë dallimet midis njerëzve mbi çfarëdo qoftë baze (përkatësi gjinore dhe etnike, moshë, aftësi, status shoqëror, orientim seksual, etj.);
VI-A.6	të vërejë paraqitjen e stereotipave dhe paragjytimeve të vetja e të tjerët dhe t'i kundërvihet diskriminimit;
VI-A.7	të vërejë shfaqjen e dhunës verbale dhe fizike në mjedisin që e rrethon, t'i kuptojë pasojat e dhunës dhe t'i kundërvihet asaj;
VI-A.8	të kuptojë se çfarë i bashkon dhe çfarë i ndan njerëzit në komunitet, të gjejë mënyra për të kontribuar në përparimin e komunitetit, duke marrë parasysh nevojat dhe interesat e të gjithëve;
VI-A.9	të njohë grupet e pambrojtura (vulnerabël) në shoqëri të marrë pjesë në to dhe të mbështesë veprime humanitare dhe vullnetare;
VI-A.17	të analizojë ndikimin e mediave të shkruara, elektronike dhe sociale në opinionin publik dhe të zgjedhë burime të besueshme informacioni mbi të cilat do t'i bazojë pikëpamjet e veta;
<i>Nxënësi /nxënësjat kupton dhe pranon se:</i>	
VI-B.2	të gjithë njerëzit, përfshirë fëmijët, kanë të drejtë të shprehin mendimet dhe pikëpamjet e tyre dhe të marrin pjesë në vendimmarrje në lidhje me nevojat dhe interesat e tyre.

Teknikë, teknologji dhe sipërmarrje

<i>Nxënësi /nxënësjat di dhe mund:</i>	
VII-A.9	të marrë pjesë aktive në punën ekipore sipas rregullave të miratuara paraprakisht dhe duke respektuar denjësisht rolin dhe ndihmesën e të gjithë anëtarëve të ekipit;

Të shprehurit artistik dhe kulturë

<i>Nxënësi /nxënësjja di dhe mund:</i>	
VIII-A.1	të tregojë se i njeh format e ndryshme të shprehjes artistike në të gjitha fushat e kulturës (letërsi, muzikë, arte vizuale, arte skenike, arte dekorative, arkitekturë, dizajn);
VIII-A.3	t'i shprehë idetë, përvojat dhe emocionet e veta duke shfrytëzuar format artistike ose format e tjera të të shprehurit krijues (individuale ose kolektive);
VIII-A.4	të interpretojë idetë, përvojat dhe emocionet e shprehura në krijimet artistike të bëra nga të tjerët që janë pjesëtarë të kulturës së vet ose të kulturave të tjera;
VIII-A.5	të tregojë se e njeh kulturën e vet dhe mënyrat e ndryshme të shprehjes së saj nëpërmjet letërsisë dhe arteve vizuale, muzikës dhe vallëzimit, ndërtimeve dhe prodhimeve të tjera kulturore;
VIII-A.10	të identifikojë dhe të shqyrojë stereotipet dhe paragjykimet ndaj anëtarëve të grupeve të tjera kulturore që shfaqen në mjedisin e tij/saj.

REZULTATET E TË NXËNIT

Fusha programore: GJUHË DHE KOMUNIKIM

Gjithsej: 70 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi / nxënësja do të jetë në gjendje:

1. të tregojë prejardhjen dhe shkrimet e para të gjuhës shqipe;
2. të dallojë tingujt e zëshëm dhe t'i zbatojë rregullat e ndërrimeve fonetike në të shkruar e në të folur;
3. të dallojë dhe të përcaktojë theksin e fjalës dhe llojet e intonacionit në fjali sipas rregullave të drejtshqiptimit të gjuhës standarde shqipe;
4. të përdorë drejt emrin dhe kategoritë e tij gramatikor (të dallojë gjininë asnjansë dhe shumësin e emrave), të dallojë mbiemrat (të nyjshëm, të panyjshëm, gjini, numër, rasë);
5. të përdorë drejt përemrat vectorë, përemrat dëftorë dhe trajtat e shkurtra të përemrit vector;
6. të zgjedhojë drejt folje në mënyrën dëftore në kohën e tashme, në të pakryerën, në të kryerën e thjeshtë dhe në kohën e ardhme;
7. të tregojë karakteristikat e fjalisë, t'i identifikojë gjymtyrët kryesore të fjalisë së thjeshtë dhe të shpjegojë funksionin e tyre;
8. të njohë kuptimin leksikor të fjalëve dhe të japë shembuj për sinonime, antonime dhe homonime;
9. të zbatojë rregullat e përvetësuar fonetike, gramatikore dhe drejtshkrimore gjatë të shkruarit;
10. të dëgjojë dhe të lexojë për të kuptuar dhe të përdorë të dhëna nga burime të ndryshme gjatë shkrimit të një teksti.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):

Standardet e vlerësimit:

Pasqyrë e shkurtër e historisë së gjuhës shqipe.

(Prejardhja e gjuhës shqipes, shkrimet e para të gjuhës shqipe.

- Njeh prejardhjen e gjuhës shqipe.
- Njeh shkrimet e para të gjuhës shqipe.

Gjuhësia

• Komunikimi – elementet dhe llojet

(elementet e komunikimit: mesazhi, dërguesi i mesazhit, marrësi imesazhit, mjetet e transmetimit të mesazhit; shenja, simboli, sinjali, komunikimi sinjalistik dhe simbolik, komunikimi verbal dhe joverbal, komunikimi i tërthortë dhe i drejtpërdrejtë, komunikimi i njëanshëm dhe i ndërsjellë)

- Shpjegon konceptin e komunikimit.
- Shpjegon elementet e komunikimit nëpërmjet një shembulli.
- Bën dallimin ndërmjet shenjës, simbolit dhe sinjalit.
- Krahason lloje të ndryshme të komunikimit (komunikim sinjalistik dhe simbolik, komunikim verbal dhe joverbal, komunikim i tërthortë dhe i drejtpërdrejtë, komunikim i njëanshëm dhe i ndërsjellë) duke përdorur shembuj të përshtatshëm.
- Krijon dhe prezanton modele të transmetimit të mesazheve në situata të ndryshme komunikimi.
- Njeh degët kryesore të gjuhësisë.

• Pasqyrë e gjuhësisë dhe degët kryesore.

<p>Fonetika</p> <ul style="list-style-type: none"> • Klasifikimi i tingujve (zanoret dhe bashkëtingëlloret). • Rregullat drejtshkrimore për përdorimin e ë-së fundore. • Ndarja e bashkëtingëlloreve sipas shkallës së zëshmërisë (të zëshme dhe të pazëshme (të shurdhëta). • Ndërrimet fonetike: ndikimi i tingujve mbi njëri-tjetrin, zëshmimi dhe shurdhimi i tingujve të zëshëm në fund të fjalës. • Rregullat drejtshkrimore në lidhje me ndërrimet fonetike - zëshmimi dhe shurdhimi i tingujve të zëshëm në fund të fjalës. • Theksi (rrokje e theksuar, shenja e theksit, theksi fundor, parafundor dhe tejfundor). 	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon ndarjen e tingujve në zanore dhe bashkëtingëlloret. • Zbaton rregullat drejtshkrimore për përdorimin e ë-së fundore. • Identifikon bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme (të shurdhëta) në një fjalë të caktuar. • Tregon shembuj të çifteve të përbëra nga bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme (të shurdhëta). • I tregon dhe i shpjegon ndryshimet e tingujve dhe jep shembuj të zëshmimit dhe të shurdhimit të tingujve të zëshëm në fund të fjalës. • Identifikon shurdhimin e bashkëtingëlloreve të zëshme në fund të një fjale të caktuar. • Zbaton rregullat drejtshkrimore për: zëshmimin në fjalë të caktuara dhe shurdhimin e tingujve të zëshëm në fund të fjalës. • I tregon karakteristikat e theksit në gjuhën standarde shqipe (fundor, parafundor dhe tejfundor). • I thekson saktë fjalët dhe thekson rrokjen e theksuar gjatë leximit dhe gjatë të shprehurit dhe të folurit me gojë. • Shënon saktë me shenjë theksin në fjalët njërrrokëshe, dyrrrokëshe, trerrokëshe dhe shumërrrokëshe. • Identifikon dhe shënon theksin në fjalët e përbëra.
<p>Morfologjia</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesët e ligjëratës - fjalë të ndryshueshme dhe fjalë të pandryshueshme). • Emrat: llojet e emrave dhe kategoritë gramatikore të emrave (llojet -të përgjithshëm dhe të përveçëm, emra konkretë e abstraktë, përmbledhës dhe të lëndës, kategoritë gramatikore - gjinia, numri, trajta dhe rasa) • Mbiemrat: kategoritë gramatikore të mbiemrave dhe shkallët e mbiemrave (mbiemrat e nyjshëm dhe mbiemrat e panyjshëm, mbiemrat cilësorë, kategoritë gramatikore të 	<ul style="list-style-type: none"> • Përcakton klasat e fjalëve – të ndryshueshme, të pandryshueshme, i klasifikon fjalët në fjalë të ndryshueshme dhe të pandryshueshme. • Tregon llojet e emrave: të përgjithshëm dhe të përveçëm, konkretë dhe abstraktë, përmbledhës dhe të lëndës. • Identifikon llojin e emrave në një tekst të dhënë dhe jep shembuj të llojeve të ndryshme të emrave. • Identifikon dhe tregon format e emrave në gjini, numër, rasë dhe trajtë, dallon emra ambigjenë (të dygjishëm) në një tekst të dhënë. • Shpjegon rolin e mbaresës së trajtës së shquar tek emrat dhe i tregon mbaresat e trajtës së shquar sipas gjinisë dhe numrit të emrave. • Përdor drejt trajtat e kategorive gramatikore të mbiemrave gjatë të shprehurit me gojë dhe me shkrim.

mbiemrave - gjinia, numri dhe rasa, shkallët e mbiemrave - pohore, krahasore, sipërore).

- Përemrat vetorë: kategoritë gramatikore - veta, numri, gjinia dhe rasa, trajtat e shkurtra; përemrat dëftorë: kategoritë gramatikore - gjinia, numri dhe rasa
- Foljet: kuptimi; kategoritë gramatikore; klasifikimi i foljes në zgjedhime sipas mbaresës që marrin në trajtën përfaqësuese (veta e parë, numri njëjës, mënyra dëftore, koha e tashme); (veprim dhe gjendje; mënyrë, kohë, vetë, numër, diatezë; zgjedhim; kohë të thjeshta dhe të përbëra, koha e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë, koha e ardhme); foljet *jam* e *kam*; grupi foljor.

- Përdor drejt trajtën e mbiemrit duke e përshtatur me kategoritë gramatikore të emrave.
- Njih mbiemrat cilësorë, shpjegon kuptimin e tyre dhe i zbaton në komunikimin me gojë dhe me shkrim.
- Formon ndërtime emër dhe mbiemër/mbiemra duke pasur parasysh anën kuptimore dhe rregullat gramatikore.
- Formon drejt shkallën krahasore dhe sipërore të mbiemrave dhe zbaton rregullat drejtshkrimore në lidhje me shkallën.
- Shpjegon (përmes shembujve) rolin e përemrave vetorë në fjali - ato tregojnë marrëdhëniet e pjesëmarrësve në bisedë.
- Tregon përemrat vetorë në njëjës dhe në shumës, duke theksuar format për kategorinë gramatikore të gjinisë vetëm në vetën e tretë njëjës e shumës.
- Identifikon përemrat vetorë në një tekst të dhënë dhe përcakton gjininë, numrin dhe vetën e tyre.
- Identifikon përemrat dëftorë në një tekst të dhënë dhe përcakton gjininë dhe numrin e tyre.
- Lidh trajtat e përemrave dëftorë me trajtat e emrave të shquar.
- Dallon përemrat dëftorë *ai, ajo - ata, ato* nga përemrat vetorë të vetës së tretë *ai, ajo - ata, ato*.
- Dallon foljet sipas kuptimit - veprim ose gjendje.
- Dallon trajtat e foljeve sipas kategorive gramatikore të mënyrës, kohës, vetës, numrit dhe të diatezës.
- Dallon trajtën përfaqësuese - veta e parë, numri njëjës, mënyra dëftore, koha e tashme.
- Dallon kohët e thjeshta dhe të përbëra.
- Zgjedhon foljet e dhëna në kohën e tashme, të pakryer, të kryerën e thjeshtë dhe në kohën e ardhme.
- Tregon shembuj të formave të foljeve për kohën e tashme, të pakryer, të kryerën e thjeshtë dhe për kohën e ardhme.
- Zgjedhon dhe përdor foljet *jam* dhe *kam* në trajtat e kohës së tashme, të pakryer, të kryer të thjeshtë dhe të ardhme.
- Zgjedhon foljet e një kohe në kohë të tjera.

<p>Sintaksa</p> <ul style="list-style-type: none"> Fjalja: nocioni/koncepti, përmbajtja dhe lloji sipas qëllimit të thënies (fjali dëftore, fjali pyetëse, fjali dëshirore, fjali nxitëse, fjali thirrmore). Struktura gramatikore e fjalisë (fjali e thjeshtë, gjymtyrët kryesore: kryefjalë, kallëzues – kallëzues foljor; fjali e thjeshtë e zgjeruar, gjymtyrët e dyta: përcaktori, kundrinori dhe rrethanori). 	<ul style="list-style-type: none"> Identifikon fjalinë si tërësi logjike fjalësh, si ndërtim të drejtë gramatikor dhe si tërësi intonacionore. Identifikon llojet e fjalive sipas qëllimit të thënies në një tekst të dhënë. Shpjegon strukturën e një fjalie të thjeshtë dhe funksionin e kallëzuesi dhe të kryefjalës në fjali. Krijon një fjali të thjeshtë me kryefjalë dhe kallëzues. Njeh dhe dallon llojet e kallëzuesit foljor (i thjeshtë, i përbërë). Njeh strukturën e fjalisë së thjeshtë të zgjeruar dhe funksionin e gjymtyrëve të dyta. Krijon fjali me lloje të ndryshme fjalësh (emra, përemra e grup emëror) në funksion të kryefjalës.
<p>Leksikologjia</p> <ul style="list-style-type: none"> Kuptimi leksikor i fjalëve (kuptimi i fjalëve – fjalë me një kuptim, fjalë me shumë kuptime; kuptimi i drejtpërdrejtë dhe i figurshëm, kuptimi konkret dhe abstrakt i fjalëve, sinonimet, homonimet, antonimet) Fjalëformimi (fjalë e parme, e prejardhur, e përbërë) 	<ul style="list-style-type: none"> Jep shembuj të fjalëve që kanë një kuptim dhe të fjalëve që kanë shumë kuptime. Shpjegon dallimin mes kuptimit të drejtpërdrejtë dhe kuptimit të figurshëm të fjalëve nëpërmjet të shembujve. Shpjegon dallimin mes kuptimit konkret dhe atij abstrakt të fjalëve përmes shembujve. Identifikon në një tekst fjalë që kanë sinonime ose antonime dhe i tregon sinonimet ose antonimet e tyre. Në një tekst identifikon fjalët që janë homonime dhe i tregon kuptimet e ndryshme të tyre. Njeh fjalët e parme, fjalët e prejardhura dhe fjalët e përbëra.
<p>Rregullat drejtshkrimore</p> <ul style="list-style-type: none"> Përdorimi i shkronjave të mëdha Përdorimi i shenjave të pikësimit (pika, presja, pikëpyetja, dy pikat, shumëpikëshi, pikëçuditja, thonjëzat, apostrofi te trajtat e shkurtra) Ndarja e fjalëve në fund të rreshtit (shenja e pikësimit - viza) 	<ul style="list-style-type: none"> Përdor drejt shkronjën e madhe në secilën pjesë të emrave të përveçëm (emri, mbiemri, pseudonimi); në fillim të secilës pjese të emërtimit të institucioneve, organizatave, festave kombëtare. Përdor drejt shenjat e pikësimit: pikën, presjen, pikëpyetjen, dy pikat, shumëpikëshin, pikëçuditjen, thonjëzat, apostrofin te trajtat e shkurtra në komunikimin me shkrim. Ndan fjalën dhe përdor drejt vizën në fund të rreshtit.

<ul style="list-style-type: none"> • Të lexuarit për të kuptuar • Të dëgjuarit për të kuptuar • Të shkruarit e teksteve duke përdorur të dhëna 	<ul style="list-style-type: none"> • U përgjigjet pyetjeve lidhur me të dhënat e paraqitura në formë të tabelave dhe grafikëve. • U përgjigjet pyetjeve lidhur me të dhëna të paraqitura në hartë. • U përgjigjet pyetjeve lidhur me përmbajtjen e një teksti të lexuar nga një libër profesional, enciklopedi, raport. • U përgjigjet pyetjeve lidhur me një tekst të dëgjuar për një temë të caktuar. • Përmbledh në 1-2 fjali (me shkrim ose me gojë) tekstin e dëgjuar ose të lexuar prej 5-6 fjalish. • Shpreh qëndrim (me shkrim) për një temë në një tekst të lexuar dhe e mbështet atë me citate nga teksti. • Nxjerr të dhëna nga një tekst profesional i lexuar në lidhje me një temë të caktuar. • Shkruan një tekst joletrar duke përdorur të dhëna nga burime të ndryshme (libra profesionistë, tekste shkollore, gazeta, revista, fjalorë, enciklopedi). • Citon drejt burimet e të dhënave që përdor gjatë shkrimit të teksteve.
---	--

Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):

(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)

- Secilit nxënës në mënyrë individuale i jepet një listë me tituj të ndryshëm tekstesh/veprash të njohura për nxënësit, ndër to bëjnë pjesë edhe dokumentete e para të gjuhës shqipe (“Formula e pagëzimit”, “Fjalorthi i Arnold von Harfit”, “Perikopeja e Ungjillit”). U jepet detyrë të nënvizojnë vetëm dokumente e para. Në fund diskutojnë për rëndësinë që ata kanë në formimin e gjuhës shqipe.
- Nxënësit ndahen në grupe, u jepen ilustrime në të cilat ka mjete të ndryshme komunikimi, p.sh.: televizor, telefon, kompjuter dhe më pas u jepet detyrë të mendojnë se çfarë mesazhesh mund të përcillen nëpërmjet të mjetit të paraqitur në ilustrim. Secili grup bën një prezantim të shkurtër para grupeve të tjera. Më pas fillon një diskutim me pyetje të synuara: *Si quhet procesi në të cilin bëhet shkëmbimi i mesazheve /informatave? Çfarë përdorët si mjet për të përcjellë mesazhet? A përdorët vetëm fjalë? A përdorët gjeste dhe mimika të fytyrës? Si quhet ai që e dërgon mesazhin dhe si quhet ai që e merr (pranon) mesazhin?* Nxënësit në grupe, duke përdorur teknikën *Kalavesh*, i paraqesin elementet bazë të komunikimit.
- Nxënësit punojnë në çifte. Shikojnë fotografi dhe imazhe të ndryshme të shenjave që i përdorim çdo ditë (gjethe të verdha, pëllumb me një degë ulliri në sqep, zile shkolle, makinë e zbuluar me lule, gjurmë shpute në plazh, semafor). Nën çdo foto/imazh, nxënësit duhet të shkruajnë se çfarë mesazhi është dërgua dhe si i është dërguar ky mesazh marrësit. Zhvillohet bisedë rreth asaj se çfarë është shenja, cili është roli i saj dhe cilat nga

shenjat nga ana e dërguesit janë dërguar me një qëllim të caktuar dhe cilat janë dërguar pa qëllim të paracaktuar. Më pas, nxënësit në çifte i radhisin shenjat nga shembujt në dërrasën e zezë në një tabelë të ndarë në dy kolona: sinjale dhe shenja. Disa prej çifteve e prezantojnë tabelën me shenjat e radhitura (sinjale dhe shenja) përpara gjithë klasës. Në fund, tabela plotësohet edhe me shembuj të tjerë të komunikimit me simbole.

- Nxënësve u prezantohen lloje të ndryshme të komunikimit përmes fotove, videove, inserteve. Nxënësit i identifikojnë dhe i shpjegojnë përmes diskutimit llojet e ndryshme të komunikimit nga prezantimi i bërë. Më pas ndahen në grupe. Secili grup krijon dhe prezanton nga një shembull për lloje të ndryshëm të komunikimit me figura dhe me fjalë. Grupet e tjera dëgjojnë dhe plotësojnë me shembuj të tyre.
- Nxënësit inkurajohen të shqiptojnë zanore dhe bashkëtingëllore dhe ta përshkruajnë lëvizjen e rrymës së ajrit gjatë shqiptimit të tyre. Duke vepruar kështu, mësimdhënësi/ja parashtron pyetje synuese përmes së cilave nxënësit arrijnë në përfundimin se gjatë shqiptimit të zanoreve, ajri, nga mushkëritë përmes trakesë, në laring i lëviz kordat e zërit duke lëvizur lirshëm nëpër zgavrën e gojës dhe duke dalë përmes buzëve. Gjatë dridhjeve të kordave të zërit nuk ka pengesa dhe këta tinguj, zanoret, dëgjojnë qartë. Nxënësve u parashtrihen pyetjet synuese edhe lidhur me bashkëtingëlloret, të cilat e kalojnë rrugën e njëjtë nëpër organe, por ato gjatë shqiptimit hasin në pengesa në pjesë të ndryshme të zgavrës së gojës. Nxënësit shkruajnë një përfundim të përbashkët dhe e ndajnë atë në klasë.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet një sërë shembujsh me fjalë që përmbajnë zanoren -ë në një pozicion fundor: *nënë, dajë, i mirë, besnikë (shumës), lehtë, ftohtë, ynë, të tutë, pesë, shtatë, mbajmë, të punojë*. Grupet kanë për detyrë në dërrasën e zezë t'i ndajnë fjalët nëpër kolona sipas përkatësisë në klasat e fjalëve (emra, mbiemra...). Në bazë të shembujve nxënësve u tregohet se ë-ja fundore përmbahet tek emrat, mbiemrat, ndajfoljet, përemrat pronorë, numërorët, foljet. Në fund nxënësit i shqiptojnë drejt fjalët dhe e perceptojnë drejtshkrimin e ë-së fundore.
- Nxënësve u paraqitet ndarja e tingujve sipas kriterit të zëshmërisë në një organizues grafik të zgjedhur nga mësimdhënësi/ja. Inkurajohen nxënësit që t'i shqiptojnë tingujt, duke ndjekur shembullin e paraqitur nga mësimdhënësi/ja dhe që të vërejnë dallimet në shqiptim. Me pyetje dhe shpjegime synuese, mësimdhënësi/ja i shpie në përfundimin kryesor - dridhja e kordave të zërit, gjegjësisht tendosja e tyre gjatë shqiptimit, krijon zëshmërinë e tyre. Zanoret janë më të zëshme, pastaj vijin sonantet dhe në fund janë bashkëtingëlloret. Gjatë shqiptimit të bashkëtingëlloreve, nëse kordat e zërit nuk janë të zgjatura, por janë të relaksuara, krijohen bashkëtingëlloret e pazëshme (të shurdhëta). Në fund nxënësit i dallojnë tingujt e zëshëm dhe të pazëshëm në fjalët e dhëna dhe i kontrollojnë ato së bashku.
- Nxënësve u jepen karta me tinguj. Mësimdhënësi/ja vendos në dërrasën e zezë një tregues/tabelë çiftesh të bashkëtingëlloreve të zëshme dhe të pazëshme. U shpjegon që t'i lexojnë në çifte ashtu siç tregohet në tabelë, në mënyrë që nxënësi që ka kartën me shkronjën *B* e shqipton, e menjëherë pas tij ai që ka kartën me shkronjën *P* e shqipton *P*-në dhe kështu me radhë deri në *H*-në e shurdhët. Shqiptimi në çifte përsëritet disa herë. Më pas nxënësit marrin një tabelë në të cilën çiftit i mungon një bashkëtingëllore. Nxënësit kanë për detyrë ta plotësojnë tabelën dhe ta kontrollojnë së bashku. Në fund të aktivitetit në një pentagram të improvizuar dhe me ngjyra të ndryshme, nxënësit i shkruajnë tingujt sipas zëshmërisë, në mënyrë që zanoret të qëndrojnë në rreshtat e sipërm, ndër to janë sonantet, më pas bashkëtingëlloret e zëshme dhe më poshtë bashkëtingëlloret e pazëshme (të shurdhëta).
- Nxënësit shikojnë në tabelë disa shembuj të përngjashmimit të bashkëtingëlloreve dhe diskutojnë për mënyrën e shqiptimit të tyre, d.m.th cili është shqiptimi më i lehtë kur në fjalë bashkëtingëlloret e zëshme dhe ato të pazëshme qëndrojnë pranë njëra-tjetrës, p.sh.: *ekzistoj - egzistoj, s'di - z'di,*

etj. Nxënësit përfundojnë se për shkak të përshtatjes së tingujve, për shqiptim më të lehtë, ndodh një ndryshim i tingujve që quhet ngjashmimi i bashkëtingëlloreve (njësim sipas zëshmërisë). Më pas nxënësit punojnë individualisht në një tekst në të cilin ka fjalë ku ndodh ngjashmimi. I gjejnë fjalët e shkruara gabim, diskutojnë për ato dhe pastaj i shkruajnë në tabelë për të perceptuar drejtshkrimin.

- Nxënësit i shqiptojnë fjalët në tabelë dhe vërejnë se cila fjalë në çfarë mënyre shqiptohet: *prag - prak, zog - zok, djeg - djek* etj. Duke u rikujtuar në paraqitjen tabelare të çifteve të zëshme të pazëshme, diskutojnë për bashkëtingëlloret e zëshme dhe të pazëshme. Arrijnë në përfundimin se bashkëtingëlloret e zëshme në fund të fjalës shqiptohen si të pazëshme, sepse ashtu është më lehtë, por shurdhimi nuk shënohet në të shkruar.
- Nxënësit ndjekin një prezantim në të cilin tregohen ndryshimet e ngjashmimit sipas zëshmërisë dhe shurdhimit të tingujve në fund të fjalës. Gjatë leximit të shembujve dhe përmes pyetjeve nxënësit kuptojnë se ndryshimet e ngjashmimit janë të kushtëzuara nga rrethimi fonetik dhe nga pozicioni (shurdhimi i bashkëtingëlloreve në fund të fjalës). Nxënësit vazhdojnë të punojnë në çifte. Çdo çift merr një fletë me një tekst në të cilin ndërrimet e tingujve nuk janë shënuar/shkruar drejt dhe ata i korrigjojnë ato. Punën e bërë e prezantojnë përpara gjithë klasës duke respektuar drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin.
- Nxënësit punojnë në çifte. U jepet një tekst, e lexojnë dhe prej tij nxjerrin dhjetë fjalë sipas zgjedhjes së tyre. I ndajnë fjalët në rrokje. I shqiptojnë ato dhe vërejnë se cila rrokje është e theksuar. E shënojnë me shenjën e theksimit dhe diskutojnë nëse theksimi ndryshon në varësi të asaj nëse fjala merr një prapashtesë ose pëson ndonjë ndryshim tjetër. Përfundimet për karakteristikat nxënësit i nxjerrin vetë sipas udhëzimeve të mësimdhënësit/es dhe i shkruajnë në tabelë.
- Nxënësit dëgjojnë një audio inçizim në të cilin folësi thekson fjalët dyrrrokëshe dhe trerrokëshe një herë gabimisht dhe një herë drejt. Diskutojnë për dallimet mes dy regjistrimeve. Pastaj dëgjojnë përsëri dhe analizojnë. Atyre u shpjegohet se dallimet janë për shkak të thekseve të ndryshme. Më pas, shembujt vendosen në tabelë. Mësimdhënës/ja lexon shembujt duke theksuar drejt dhe u kërkon nxënësve ta shënojnë ngritjen e zërit /theksimin e një rrokjeje në fjalë. Në pjesën e fundit mësimdhënësi/ja paraqet rregullin për theksimin: në fjalët njërrrokëshe theksi bie në zanorene e vetme (*mik, qen, ha*); kemi theks fundor kur theksi bie në rrokjen e fundit të fjalës (*shtëpi, ushtri, liri*); theks parafundor kur theksi bie në rrokjen e parafundit të fjalës (*shkollë, derë, pulë*) dhe theks tejfundor kur theksi bie në rrokjen e tretë dhe të katërt nga fundi (*flutura, kumbulla, fshehurazi*). Më pas nxënësit marrin një listë me fjalë dyrrrokëshe dhe trerrokëshe që duhet t'i shkruajnë të ndara në rrokje dhe shënojnë rrokjen mbi të cilën bie theksi. Në fund, nxënësit i lexojnë me zë fjalët nga lista, një herë duke i theksuar drejt dhe më pas duke e shqiptuar fuqishëm rrokjen e theksuar..
- Nxënësit në mënyrë të pavarur zgjedhin një tekst (të çfarë do stili), e lexojnë para klasës, duke respektuar rregullat e theksit që kanë mësuar. Për detyrë kanë të dëgjojnë me vëmendeje, të mbajnë shënime për theksimin dhe t'i japin komente njëri-tjetrit pas çdo leximi duke u bazuar në shënime të mbajtura për fjalët e theksuara gabimisht.
- Nxënësve u jepet një fletë pune ku ka dy kolona: njëra e përcaktuar si kolonë në të cilën ndodhen fjalët: *hekur, udhë, krye, radhë, sy, shqiptonjë, lule, lakër, ballë, hapur*, kurse tjetra si kolonë në të cilën formohen dhe shkruhen fjalë të reja të përbëra nga dy pjesë: *hekurudhë, kryeradhë, syshqiptonjë, lulëlakër, ballëhapur*. Pas përfundimit të detyrës, nxënësit një herë i lexojnë fjalët që u janë dhënë në kolonën e parë, kurse pastaj i lexojnë fjalët e reja të kolonës së dytë dhe i shkruajnë në tabelë. Njëpërmjet të pyetjeve nxënësit konstatojnë se ekzistojnë fjalë të parme dhe fjalë të përbëra dhe

se te fjalët e përbëra theksi bie mbi temën e parë. Pas përfundimit të aktivitetit disa nxënës në tabelë shkruajnë nga një shembull të fjalës së përbërë dhe e shqiptojnë drejt.

- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet dy fletë me ngjyra të ndryshme. Në fletën me ngjyrë të kuqe shënojnë pjesët e ndryshueshme të ligjeratës, ndërsa në fletën e kaltër shënojnë pjesët e pandryshueshme të ligjeratës. Secili grup prezanton para të tjerëve punën e bërë dhe në fund diskutohet për rolin e tyre në fjali.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr një fletë me detyra të ndryshme: të bëhet regjistrimi i inventarit të të gjitha sendeve në klasë, të numërohen emrat e sendeve që përdoren gjatë përgatitjes së ushqimit, të jepet një recetë, të krijohet një tekst i shkurtër plot me emra nga një fushë e caktuar - për shembull nga ndërtimtaria, ose tekst me një listë artikujsh nga një butik, etj. Më pas bëjnë një tabelë në të cilën përcaktojnë se cilët nga emrat janë: të përveçëm dhe të përgjithshëm, konkretë dhe abstraktë, përmbledhës dhe të lëndës (disa nga emrat mund të gjenden në disa kolona të tabelës). Detyra e nxënësve është të kërkojnë çka është e përbashkët dhe çka është e veçantë për emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm, konkretë dhe abstraktë, përmbledhës dhe të lëndës. Secili grup përfundimet i prezanton përpara klasës.
- Nxënësit punojnë në çifte. U jepet një fletë me dy tabela. Njëri-tjetrit duhet t'i thonë nga pesë emra të përgjithshëm dhe t'i shkruajnë në tabela, duke përcaktuar gjininë dhe numrin e emrave të shkruar. Disa nxënës shembujt i lexojnë para të gjithëve.
- Nxënësit ndahen në çifte dhe u jepen disa fjali që përmbajnë emra, disa prej të cilëve janë emra ambigjenë (të dygjinishëm), p.sh.: **Mali i lartë qëndronte krenar mbi lumë; Malet e larta dukeshin nga larg; Mendimi i ri jep edhe shpesë të re; Të gjithë shprehën mendime të reja. Prodhimtaria është një biznes i rëndësishëm; Viteve të fundit janë zhvilluar biznese të rëndësishme.** Në fletë janë shënuar me shkronja të hijezuara: **mal i lartë; malet e larta; mendim i ri; mendime të reja; biznes i rëndësishëm, biznese të rëndësishme.** Nxënësit kanë për detyrë ta përcaktojnë gjininë e emrave dhe të diskutojnë për këtë. Ata përfundojnë se disa emra të caktuar në gjuhën shqipe janë të dygjinishëm.
- Nxënësve u jepet një tekst përplot me emra. Mësimdhënësi/ja i udhëzon t'i shkruajnë emrat në fletoret e tyre. Shembujt me emra në trajtën e shquar dhe emra në trajtën e pashquar shkruhen në tabelë, kurse nxënësit i shqyrtojnë këta shembuj dhe nxjerrin përfundimet e tyre, duke i analizuar mbaresat e trajtës së shquar. Më pas, nxënësit japin shembuj të tyre, fjali në të cilat përdorin emra të shquar e të pashquar. I lexojnë dhe komentojnë se çfarë tregojnë mbaresat: emrat që në numrin njëjës në trajtën e shquar në rasën emërore marrin mbaresën *-i* apo *-u* janë emra të gjinisë mashkullore; emrat që në numrin njëjës në trajtën e shquar në rasën emërore marrin mbaresën *-a* apo *-ja*, janë emra të gjinisë femërore dhe emrat që në fund marrin mbaresat *-it*, *-t* dhe *-të* janë emra të gjinisë asnjënjësore. Së bashku me mësimdhënësin/en përfundojnë se shquarsia e emrave shërben edhe për të dalluar gjininë e tyre.
- Nxënësit punojnë në çifte. Tërheqin disa karta me emra. Për detyrë kanë që njëri nxënës të tërheqë një kartë dhe t'ia lexojë emrin tjetrit. Ai duhet ta kthejë në trajtën e shquar dhe ta shkruajë në fletore dhe pastaj të përcaktojë gjininë dhe numrin e tij. Më pas nxënësit i ndërrojnë rolet e tyre. Disa nxënës i shkruajnë përgjigjet e tyre në tabelë duke i treguar kategoritë gramatikore të emrave.
- Nxënësit marrin pjesë në çifte në një aktivitet loje "Qëlloje objektin dhe përshkruaje atë". Çdo nxënës duhet të imagjinojë një objekt që ndodhet në klasë. Më pas, çdo nxënës në një fletë letrë duhet të shkruajë tri mbiemra që e përshkruajnë objektin e imagjinuar (për shembull, nëse nxënësi

imagjinon fjalën "derë" mund t'i shkruajë mbiemrat: *e drunjtë, e bardhë, e madhe*). Më pas nxënësit i ndërrojnë fletët dhe secili duhet ta qëllojë objektin e imagjinuar nga shoku i tij në bazë të mbiemrave të shkruar. Çifti merr pikë kur të dy nxënësit e çiftit e qëllojnë fjalën e shokut të vet dhe i thonë kategoritë gramatikore të mbiemrave të përdorur për të përshkruar fjalën/emrin.

- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin tekste në të cilat i nënvizojnë emrat dhe i përcaktojnë kategoritë gramatikore të tyre: trajtën, gjininë, numrin dhe rasën. Më pas shkruajnë nga disa mbiemra për secilin emër dhe ndërtojnë një fjali. Pas përfundimit të aktivitetit, grupet bëjnë komentet e tyre rreth lidhjes mes shquarsisë së emrit dhe nyjës së përparme të mbiemrave të nyjshëm në shembujt e dhënë.
- Nxënësve u jepen ilustrime si motivim për të bërë përshkrime të gjërave që do të zgjedhin nga ilustrimi. Secili shpjegon veçmas kuptimin e mbiemrave cilësorë që ka përdorur.
- Në një fletë nxënësve u jepet një tekst i shkurtër me përmbajtje që lidhet me disa nga përmbajtjet e lëndëve të tjera. I gjejnë emrat në tekst dhe më pas gjejnë mbiemra, me të cilat ndërtojnë bashkim të drejtë kuptimor dhe gramatikor, emër dhe mbiemër/mbiemra.
- Nxënësit punojnë në grupe. Përpara çdo grupi vendosen tri objekte që karakterizohen nga e njëjta veti që përfaqësohet në një shkallë më të vogël ose më të madhe. Brenda grupit, nxënësit duhet të përcaktojnë se në cilin objekt vetia e njëjtë është e përfaqësuar në një shkallë më të vogël, gjegjësisht më të madhe. Më pas krahasojnë dy objekte dhe përcaktojnë se në cilin objekt vetia është e përfaqësuar në një shkallë më të madhe/më të vogël. Nga mbiemrat e përdorur nxënësit në grupe ndërtojnë fjali dhe më pas nga një nxënës prej grupeve i shënon fjalitë në tabelë duke prezantuar atë që kanë bërë dhe së bashku komentojnë dhe perceptojnë karakteristikat në lidhje me kategorinë e shkallës. Së bashku me mësimdhënësin/en arrijnë në përfundimin se mbiemrat cilësorë e kanë kategorinë gramatikore të shkallës dhe se dallojnë dy forma të shkallës (krahasore dhe sipërore).
- Nxënësit qëndrojnë në një rreth. Ata i kalojnë njëri-tjetrit një top. Ai që ka topin thotë një emër dhe ia hedh topin dikujt në rreth. Ai që merr topin thotë një mbiemër dhe e kalon topin përsëri, personi i tretë e përdor atë mbiemër në një nga shkallët e mbiemrit. Veprimi përsëritet për sa kohë që ka interes për lojën.
- Mësimdhënësi/ja i paraqet format themelore të përemrave vetorë: në njëjës veta e parë **unë**, veta e dytë **ti**, veta e tretë **ai, ajo**; në shumës veta e parë **ne**, veta e dytë **ju**, veta e tretë **ata, ato**. Nxënësit marrin një tekst në të cilin janë përdorur të gjithë përemrat vetorë, në vetë dhe në numër të ndryshëm. Ata kanë për detyrë t'i gjejnë, t'i nënvizojnë dhe t'i përcaktojnë kategoritë e tyre - vetën, numrin dhe gjininë nëse janë në vetën e tretë. Pasi t'i lexojnë përemrat vetorë të identifikuar, përmes diskutimit nxjerrin përfundimin se kur përdoren format bazë të përemrave vetorë: veta e parë është personi që flet; veta e dytë është personi të cilit i flitni; veta e tretë është personi për të cilin flitet. Nxënësit, të ndarë në grupe, ndërtojnë fjali në të cilat i përdorin drejt përemrat vetorë (duke shpjeguar lidhjen e tyre me pjesëmarrësit në situatën e bisedës) që i thonë me gojë dhe fjali që i shkruajnë.
- Nxënësit punojnë të ndarë në grupe. U jepet një tekst në të cilin përdoren përemrat dëftorë. Ata kanë dy detyra: t'i gjejnë të gjithë përemrat dëftorë dhe të përcaktojnë numrin dhe gjininë e tyre. T'i gjejnë emrat në trajtën e shquar dhe t'i zëvendësojnë me një përemër dëftor. (P.sh. *Djali shkruante*

me shumë kujdes/ Ky djalë shkruante me shumë kujdes. Vishe bluzën./Vishe atë bluzë.) Më pas diskutojnë për dallimin mes përemrave vetorë në vetën e tretë, njëjës dhe shumës dhe përemrave dëftorë *ai, ajo, ata, ato*. Secili grup shënon nga dy shembuj të rinj për çdo lloj përemri dëftor.

Nxënësit ndahen në çifte dhe me ndihmën e teknikës *Punë në minutë* kanë për detyrë të shkruajnë në fletore pesë folje dhe më pas t'i përdorin për të ndërtuar pesë fjali. Në shembujt, së pari përcaktojnë se çfarë tregon folja: veprim ose gjendje. Në të njëjtët shembuj me folje, nxënësit më pas dallojnë mënyrën, kohën, vetën, numrin, diatezën. Punën e tyre e prezantojnë duke i shkruar shembujt në dërrasën e zezë. Më pas nxënësit marrin një fletë me një tabelë me dy kolona ku duhet t'i shënojnë foljet nga dërrasa e zezë dhe t'i vendosin në kolona sipas kërkesave të përcaktuara. Në kolonën e parë duhet të vendosen foljet që shprehin një veprim që është në proces të kryerjes dhe në kolonën e dytë duhet të vendosen foljet që shprehin një veprim të përfunduar, duke ushtruar kështu dallimin mes kohës së tashme dhe kohës së kryer të thjeshtë. Të gjitha përgjigjet kontrollohen së bashku në klasë.

- Nxënësit kanë për detyrë t'i gjejnë foljet në një tekst të dhënë, që mund të jetë një poezi ose një tekst i përbërë prej disa fjalish. Pasi i ndajnë, përcaktojnë trajtën përfaqësuese të foljes dhe kohën në të cilën është përdorur. Më pas nxënësve u tregohet se si mund të zgjedhojnë një folje në platformë të internetit duke futur për kërkim trajtën përfaqësuese të saj. Në internet kontrollojnë nëse e kanë zgjedhur drejt foljen në kohët e caktuara. Sapo kontrollojnë, e kthejnë foljen: nga koha në të cilën është në një kohë tjetër.
- Nxënësit punojnë në çifte. U jepet një fletë ku janë shkruar pesë folje në kohën e pakryer. Për detyrë kanë t'i kthejnë ato në kohën e kryer të thjeshtë. Më pas, pesë folje të kohës së kryer të thjeshtë i kthejnë në kohën e pakryer. Ata e prezantojnë punën para gjithë klasës.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet një komplet fletëzash (që mund të bashkohen në një tërësi) ku janë shënuar pjesë të foljeve. Pjesët janë: *tema (p.sh. lexo, puno, mëso)* dhe *mbarësia (-j, -jmë, -ni)*. Në fletëza duhet të ketë edhe tema foljesh që nuk kanë mbaresë (për të kuptuar se foljet mund edhe të mos marrin mbaresa në tri vetat në njëjës) dhe tema foljesh të parregullt (për të kuptuar se ato nuk i takojnë as zgjedhimit të parë, as zgjedhimit të dytë, as zgjedhimit të tretë). Kanë për detyrë t'i formojnë foljet (p.sh. pjesa që përmban temën *lexo-* bashkohet me pjesën që përmban mbaresën *-j*; pjesa që përmban temën *hap* nuk bashkohet me mbaresë në tri vetat në njëjës etj), t'i lexojnë dhe pastaj secili të shkruajë nga një fjali me këto folje në fletoren e tij. Më pas fjalitë i lexojnë përpara gjithë nxënësve të klasës.
- Nxënësit punojnë në grupe të vogla prej katër vetash. Secilit grup i jepet teksti i njëjtë. Për detyrë kanë t'i gjejnë foljet dhe të përcaktojnë se cilit zgjedhim i përket. Paraprakisht u tregohet se sa folje ka në tekst dhe sa prej tyre i përketin zgjedhimit të parë, sa zgjedhimit të dytë, sa zgjedhimit të tretë dhe sa nuk i përketin as të parit, as të dytit, as të tretit. Fitues është grupi që përfundon i pari dhe i përgjigjet saktë detyrës.
- Nxënësit i përdorin fjalitë e aktivitetit të mëparshëm dhe kanë për detyrë t'i krahasojnë kohët e foljes. Ata duhet të shohin se katër nga kohët janë të thjeshta (koha e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë dhe e ardhme). Në një prezantim mesimdhënësi/ja, me shembuj, ua tregon të gjitha kohët e foljes në mënyrën dëftore dhe duke e treguar ndërtimin në mënyrë vizuale, i thotë kohët e thjeshta dhe kohët e përbëra.
- Nxënësit punojnë në grupe. Secilit grup i jepet një fletë me shembuj të foljeve në kohën e tashme, në të pakryerën, në të kryerën e thjeshtë dhe në të ardhmen. Fleta ka katër kolona dhe në çdo kolonë shkruhet emri i kohës së foljes: koha e tashme, e pakryer, e kryer e thjeshtë, e ardhme. Grupet

kanë për detyrë t'i vendosin foljet nëpër kolona, duke i zgjedhur me mbaresa (p.sh. *-ja, -je, -nte, -nim, -nit, -nin*) dhe me pjesëza (*do, të*) sipas kohës përkatëse. Kontrollon puna e bërë para gjithë klasës dhe mësimdhënësi/ja jep informatë kthyesë.

- Nxënësit ndahen në grupe të vogla. Secilit nga grupet i jepet një zarf ku ka nga katër fjali, të cilat ndërtohen me folje që janë në kohë të tashme, në të pakryerën, në të kryerën e thjeshtë dhe në të ardhmen dhe që kanë kuptime të ndryshme. Nxënësit duhet t'i tregojnë kuptimet e trajtave të foljeve të përdorura në katër fjalitë. Secili grup i jep përgjigjet për kërkesën e dhënë. Nëpërmjet të diskutimit, mësimdhënësi/ja dhe nxënësit nxjerrin përfundime për kuptimet e trajtave foljore (kohëve) të përdorura në situatat e fjalive të dhëna.
- Nxënësit luajnë lojën *Unë jam - ti je*: tërheqin fotografi të vogla në të cilat janë të ilustruara insekte, kafshë, objekte... Disa prej tyre përsëriten. Ata qëndrojnë në një rreth dhe loja fillon ashtu që mësimdhënësi/ja tregon një ilustrim nga fotografitë. P.sh.: një flutur dhe thotë: "*Unë jam flutur*". Nëse edhe dikush tjetër e ka atë ilustrim, pra është flutur dhe është afër mësimdhënësit/es, ai/ajo bën një hap para në brendinë e rrethit dhe mësimdhënësi/ja thotë: "*Ti je flutur*". Nëse nxënësi është më larg nga mësimdhënësi/ja, thotë: "*Ai është flutur*". Nëse ka më shumë nxënës, në varësi të pozicionit, mësimdhënësi/ja thotë: "*Ne jemi flutura, ju jeni flutura, ato/ata janë flutura*". Gjatë çdo ndërrimi të fotografisë, mësimdhënësi/ja mban llogari për pozicionin e nxënësit të cilit i drejtohet. Më pas, i shkruan në tabelë fjalitë e një fotografie dhe flet me nxënësit për atë që shohin në tabelë. Nxënësit duhet t'i perceptojnë përemrat vectorë, por edhe trajtat e foljes ndihmëse *jam* në kohën e tashme. Loja përsëritet duke u thënë nxënësve që të imagjinojnë se kanë ëndërruar se kanë qenë ato që ishin në fotografinë e vogël, kështu që shprehja tani do të jetë: "*Ëndërrova se unë isha flutur...*" dhe kështu i shohim trajtat e foljes ndihmëse *jam* në kohën e pakryer. Në vijim, nxënësit e ndarë në dy grupe kanë për detyrë të hartojnë një tekst me dhjetë fjali, por njëri grup duhet të përdorë trajtat e foljes ndihmëse *jam* në kohën e tashme, kurse grupi tjetër duhet të përdorë trajtat e foljes ndihmëse *jam* në kohën e pakryer. Secili grup e lexon tekstin e tij dhe diskutohet për ndryshimet që ndodhin në trajtat e foljes ndihmëse *jam* për të dyja kohët.
- Nxënësve u jepen ilustrime të ndryshme që do t'u ndihmojnë të shkruajnë fjali duke përdorur foljet *jam* dhe *kam*. Udhëzohen që t'i përdorin ato në vetë dhe numër të ndryshëm si dhe në kohë të ndryshme. (p.sh. *Ky njeri në të kaluarën kishte makinë të shtrenjtë dhe luksoze, tani ka vetëm një biçikletë me të cilën bën një rekreim të suksesshëm*).
- Nxënësit ndahen në tri grupe. Secili grup i jepet i njëjtin tekst, por në tekstin e njëjtë foljet përdoren në kohë të ndryshme. Detyra është të zbulohet me cilën kohë të foljes shprehen veprimet në tekst dhe si të shkruhet forma e foljes për kohën e dhënë. Grupet i shkruajnë shembujt në tabelë, duke treguar kohën kur kryhet veprimi i foljes.
- Nxënësit luajnë lojë me një top tenisi. Ai që ka topin thotë një fjali në kohën e tashme, ia hedh topin një nxënësi tjetër dhe ai duhet ta shndërrojë fjalinë në kohën e ardhme, pastaj nxënësi tjetër që merr topin e shndërron atë në kohën e shkuar. Nxënësit shkruajnë fjalitë në fletore dhe hartojnë një tekst të shkurtër nga fjalitë e shkruara.
- Nxënësve u jepet një fletë në të cilën është shkruar një fjali. Me gërshërë e presin fjalinë në atë mënyrë që secila fjalë të përfaqësojë një pjesë të veçantë, një njësi më vete. Nga nxënësi kërkohet që saktë të bashkojë pjesët e letrës, në mënyrë që të krijojë një fjali të saktë që do të përfaqësojë një njësi gjuhësore kuptimplote të përbërë nga elementet bazë të saj.

- Nxënësit ndahen në 4 grupe dhe secili grup tërheq një fletë me detyra nga kutia apo strajca. Në fleta ka të shkruar: *trego, dëshiro, pyet, urdhëro*. Në varësi të fjalës që kanë tërhequr, ata duhet të formojnë 3 fjali përmes të cilave do të shprehin qëndrimin e folësit. (P.sh.: *Dje isha në Manastir. Jetofsh sa malet. Ku po shkon? Hape derën!*) Lexohen fjalitë, diskutohet se me çfarë qëndrimi shprehet, çfarë nënkuptojnë dhe me çfarë intonacioni lexohen/intonohen.
- Nxënësit kanë për detyrë të krijojnë një afishe (poster) me ndihëm e ndonjë aplikacioni të disponueshëm në internet, në të cilën si lajm kryesor do të përdorin një fjali dëftore, pyetëse, dëshirore, thirrmore. (*Sot moti do të jetë me dielli. Kush është fajtor për atë që ndodhi?* etj.) Në orën mësimore i prezantojnë afishet. Së bashku bëjnë lektorimin e fjalive dhe perceptojnë përdorimin e shenjave të pikësimit.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup merr një tekst të shkurtër në të cilin janë shënuar fjali të thjeshta. Detyra e tyre është që t'i analizojë fjalitë. Nga cilat pjesë përbëhen? Çfarë informacioni na japin? Cili është funksioni i fjalive të thjeshta?
- Ndahen nxënësit në çifte. Çdo çift merr karta në të cilat janë shkruar lloje të ndryshme fjalësh. Duhet të zgjedhin fjalë të përshtatshme dhe të formojnë fjali. Në vazhdim marrin për detyrë ta largojnë kartën ku është shkruar kallëzuesi. Hapet diskutim se a mund të qëndrojë fjalia pa kallëzues?
- Nxënësit ndahen në çifte. Çdo çift bën tabelën e vet të emrave, përemrave, mbiemrave dhe foljeve. Më pas përdorin fjalët e shkruara për të formuar fjali të thjeshta. Në fjali nënvizojnë se kush e kryen veprimin dhe cila fjalë përfaqëson vetë veprimin e foljes. Në tabelë shkruhen disa fjali dhe përcaktohet kryefjala dhe kallëzuesi.
- Nxënësit ndahen në pesë grupe (ndarja është 1, 2, 3, 4, 5 - emërtohen me numra). Brenda secilit grup luhet pantomimë: "*Qëlllo çfarë po bëj*" Një nxënës/e qëndron përballë grupit dhe bën disa lëvizje, nxënësit duhet të qëllojnë veprimin dhe më pas të bëjnë një fjali me atë folje. (P.sh.: Sara bën lëvizje që po vrapon, nxënësit shkruajnë: *Sara po vrapon*). Pastaj mësimdhënësi/ja ua jep foljet modale (*mund, duhet, filloj, zë, nis, vazhdoj, përfundoj*) dhe u thotë të zgjerojnë fjalitë duke i përdorur edhe ato. (*Sara filloi të vrapojë*). Më pas me nxënësit diskutohet për format e kallëzuesit foljor dhe se kallëzuesi mund të jetë i thjeshtë dhe i përbërë.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet fletëza me ngjitëse në të cilat janë shënuar gjymtyrët e fjalisë (*kryefjala; kallëzuesi; përcaktori; kundrinori; rrethanori*). Mësimdhënësi/ja në dërrasën e zezë krijon një tabelë me dy kolona: *gjymtyrët kryesore të fjalisë dhe gjymtyrët e dyta të fjalisë*. Detyra e secilit grup është që fletëzat t'i ngjese në kolonën përkatëse. Së bashku diskutojnë rreth funksionit të tyre në fjali.
- Nxënësit ndahen në grupe. Çdo grupi i jepet një fletë pune me shembuj për: emra, përemra ose numërorë. Detyra e grupeve është që ta përdorin çdo fjalë nga fleta e punës në funksion të kryerësit të një veprimi foljor gjatë krijimit të një fjalie. Më pas fjalitë lexohen në grup dhe shkruhen në dërrasën e zezë. Kështu kontrollohet saktësia e detyrës. Në fund diskutohet se cilat fjalë dalin në funksion të kryefjalës.
- Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çifti i jepet një fletë pune me një tekst, përmbajtja e të cilit është e pasur me fjalë me një kuptim dhe fjalë me shumë kuptime. Nxënësit duhet t'i tregojnë fjalët që kanë vetëm një kuptim dhe fjalët që kanë dy, tri ose më shumë kuptime. Nxënësit vazhdojnë të punojnë në grupe me detyrën e njohjes së fjalëve dhe shprehjeve me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm, me kuptim konkret dhe abstrakt dhe ta riformulojnë fjalinë duke i përdorur fjalët/shprehjet prej të cilave kuptimet do të njihen drejtpërsëdrejti (p.sh.: *Lina gjeti një unazë floriri. Gjysh Sokoli ka një zemër floriri; Nëna ime mban një pjatë në dorë. Ajo mban mbiemrin e saj të vajzërisë.*). Grupet i lexojnë me zë fjalitë e sapo

përpiluara dhe të gjithë së bashku diskutojnë për shprehshmërinë e tekstit në të cilin përdoren fjalë/shprehjet me kuptim të figurshëm. Në fund mësimdhënësi/ja paraqet fjali me kuptim të drejtpërdrejtë dhe të figurshëm (p.sh.: *Sa i bukur mali!* - *Ti je njeri mali!*) dhe në diskutim nxënësit e interpretojnë kuptimin e tyre.

- Nxënësit punojnë të pavarur mbi detyrat dhe kërkesat e paraqitura në fletën e punës. Para së gjithash, duke e përdorur teknikën *Pica*, ata duhet të shkruajnë në çerekun e copave të picave kuptime sinonime për një fjalë të dhënë, për shembull: *e bukur* (*e pashme, e shkëlqyer, tërheqëse, magjepsëse*). Në vazhdim të aktivitetit shënojnë në tabelë kuptimin e kundërt të fjalëve të dhëna më parë. Duke i përdorur antonimet dhe sinonimet nga fleta e punës, nxënësit krijojnë fjali. Nga disa homonime të dhëna, ata hartojnë fjali për të treguar kuptimet e ndryshme të fjalëve (*Qeni u shtri mbi barin e njomë./ I sëmuri e morri barin në orën e duhur*). Disa nxënës i lexojnë shembujt e tyre përpara nxënësve tjerë në klasë.
- Mësimdhënësi/ja shkruan në dërrasë të zezë tri fjalë të parme. Nga nxënësit kërkohet që në mënyrë individuale të formojnë tri fjalë të prejardhura dhe tri fjalë të përbëra. Disa nxënës praqesin punën e bërë para të tjerëve.
- Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup merr përsipër që të shkruajë gjëra të ndryshme: (1) pesë emra gjeografikë (me një fjalë emërtimi dhe me dy fjalë emërtimi) të kontinenteve, të shteteve, të qyteteve, të oqeanëve, të liqeneve, të lumenjve, të maleve; (2) pesë emra të nxënësve në klasë; (3) pesë mbiemra të mësuesve që u japin mësim; (4) pesë pseudonime; (5) pesë emra planetësh dhe galaktikash; (6) pesë tituj të librave të preferuar; (7) pesë lëndë mësimore; (8) tri emra të institucioneve që kanë më shumë fjalë në emërtim. Grupet i shkruajnë përgjigjet në dërrasën e zezë dhe diskutojnë bashkë saktësinë e asaj që është shkruar. Në fund diskutohet për rregullat e përdorimit të drejtë të shkronjës së madhe gjatë shkrimit të emrave të përveçëm, veçanërisht kur emërtimi përbëhet nga dy e më shumë fjalë.
- Në një prezantim të përgatitur paraprakisht, nxënësit ndjekin sllajde me foto. Në fletore duhet t'i shënojnë emërtimet dhe emrat e asaj që e shohin (ngjarje historike, tubime kulturore, xhami, kishë, manastir, parti politike). Më pas shembujt shkruhen në tabelë dhe diskutohet se si janë shkruar. Pas diskutimit pasojnë sllajdet me emra të shkruar drejt. Nxënësit bëjnë korrigjime të gabimeve eventuale.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Atyre u jepet tekst të cilit i mungojnë shenjat e pikësimit: *pika, presja, pikëpyetja, dy pikat, shumëpikëshi, pikëçuditja, apostrofi, thonjëzat*. Nxënësit duhet t'i vendosin shenjat përkatëse në vendin e duhur. Në fund të aktivitetit nxënësve u jepet teksti ku shenjat e pikësimit janë përdorur drejt dhe secili nxënës e krahason me punën e tij.
- Dy nxënës/e marrin një dialog të shkurtër të cilin e interpretojnë para klasës. Nxënësit e tjerë shkruajnë atë që dëgjojnë, duke i përdorur rregullat e drejtshkrimit për ta shënuar ligjëratën e drejtë. Forma e dialogut shkruhet në një tabelë interaktive ose në një fletë pune ku shenjat për shënimin e ligjëratës së drejtë janë përdorur drejt. Pas kësaj nxënësit së bashku me mësimdhënësin/en diskutojnë për përdorimin e drejtë të shenjave.
- Nxënësve u diktohet një tekst. Përqendrimi i kontrollit të diktimit është ndarja e fjalëve në fund të rreshtit. Nxënësit kontrollojnë nëse i kanë ndarë drejt fjalët, sipas shembullit të treguar në dërrasën e zezë.
- Nxënësit punojnë në grupe dhe lexojnë e rishikojnë tekste me grafikonë, tabela dhe diagrame. Në një fletë pune, ata marrin lloje të ndryshme të pyetjeve (me rrethim, me plotësim, me përgjigje të plotë, me përgjigje saktë - gabim) që u referohen teksteve dhe duhet t'u përgjigjen atyre.

- Nxënësit ndahen në grupe. U jepet një hartë dhe secili grup duhet t'i prezantojë informacionet nga harta duke iu përgjigjur pyetjeve të parashtruara nga mësimdhënësi/ja.
- Nxënësit dëgjojnë fragmente nga libri *“Histori përpara gjumit PËR VAJZAT REBELE”* nga Elena Favili. Pas çdo teksti që dëgjojnë, u përgjigjen pyetjeve që paraprakisht u jepen në një fletë pune. Përgjigjet paraqiten para klasës. Jepen shembuj nga pjesët e lexuara të librit për gra të ndryshme të suksesshme në profesione të ndryshme. Konstatohet se vajzat dhe gratë mund të jenë të suksesshme në profesione të ndryshme (shkrimtare, pilote, hulumtuese, shkencëtare etj.).
- Nxënësve u jepet detyrë që të hulumtojnë se cilat libra profesionalë kanë në shtëpitë e tyre, të shkruajnë titujt e tyre dhe llojin e librit profesional që kanë gjetur për një temë të caktuar (fjalor, leksikon, enciklopedi, tekst shkollor etj.). Nëse nuk e gjejnë në shtëpi, mund ta vizitojnë edhe bibliotekën e shkollës dhe të marrin ndihmë nga bibliotekari. Nxënësit e paraqesin tekstin e gjetur nga literatura profesionale, nga enciklopedia ose nga ndonjë raport dhe të njëjtin e prezantojnë para shokëve të klasës. Nxënësit e dëgjojnë tekstin dhe përgjigjen në pyetjet lidhur me tekstin e dëgjuar ose të lexuar. Në fund nxjerrin përfundime dhe i thonë ato me një deri në dy fjali me shkrim ose me gojë.
- Nxënësve u jepet një fletë pune me informacione rreth disa ngjarjeve. Çdo tekst informues përmban 5-6 fjali. Nxënësit kanë për detyrë që të zgjedhin një tekst dhe përmbajtjen e tij ta përmbledhin në 1-2 fjali.
- Përmes një diskutimi të drejtuar, nxënësit flasin për profesionet dhe nëse ato mund të ndahen në profesione për meshkuj dhe profesione për gra. Më pas nxënësve u jepet një fletë mësimore me një tekst nga libri *“Njëqind gra më me ndikim në histori”* nga shumë autorë. Më pas secili nxënës duhet ta shprehë me shkrim qëndrimin e tij personal lidhur me temën dhe personazhin nga teksti i lexuar. Qëndrimet duhet të mbështeten me citate nga teksti që e kanë lexuar. Në fund lexohen punimet e nxënësve në klasë dhe konstatohet se nuk ka ndarje në profesione për meshkuj dhe për gra dhe se suksesi në një profesion të caktuar varet nga shumë faktorë të tjerë (arsimimi, profesionalizmi, përkushtimi etj.).
- Nxënësve u jepet tema për të cilën duhet të gjejnë literaturë të duhur profesionale (me ndihmën dhe orientimet e mësimdhënësit/es). Tema duhet të jetë në përputhje me moshën e tyre (p.sh. një fragment nga enciklopedia për fëmijë për temat që mësohen në lëndën e shkencave natyrore, një fragment nga enciklopedia mbi formimin e sistemit diellor, mbi zhdukjen e dinosaurëve etj.) Nxënësit në çift duhet të krijojnë të dhëna nga teksti i lexuar dhe t'i shkruajnë në fletore. Më pas u jepet detyrë që ta shkruajnë një tekst joletrar, duke përdorur të dhënat e nxjerra. Pasi mbarojnë së shkruari, citohen burimet e të dhënave që i kanë përdorur në shkrimin e teksteve. Disa nxënës i lexojnë tekstet e tyre para gjithë klasës.

Fusha programore: LETËRSI, TË SHPREHURIT DHE KRIJIMTARIA

Gjithsej: 54 orë

Rezultatet e të nxënit:

Nxënësi/nxënësja do të jetë në gjendje:

1. të shpjegojë ndarjen e letërsisë sipas formës dhe vetive të brendshme të teksteve letrare;
2. të dallojë dhe analizojë tekste autoriale dhe tekste nga krijimtaria popullore;

3. të analizojë strukturën e poezive lirike dhe të njohë figurat stilistike në poezi (rima, onomatopeja, epiteti, krahasimi dhe personifikimi);
4. të dallojë lloje të ndryshme tekstesh në prozë (mit, përrallë, tregim, roman) dhe t'i analizojë ato sipas elementeve karakteristike;
5. të ritregojë tekste, të rrëfejë ngjarje (me gojë dhe me shkrim) duke respektuar radhitjen e ngjarjeve në tekst;
6. të shkruajë tekst për një temë të caktuar dhe për një temë të zgjedhur, duke respektuar rregullat e kompozicionit dhe rregullat drejtshkrimore.

Nxënësi/nxënësjë:

1. do të zhvillojë vetëdijen për nevojën e leximit të veprave letrare;
2. do të formojë mendim dhe do të mbajë qëndrim për tema nga veprat letrare;
3. do të zhvillojë mendim krijues.

Përmbajtjet (dhe nocionet/konceptet):	Standardet për vlerësim:
<p>Ndarja e letërsisë:</p> <p>Sipas vetive të brendshme: lirika, epika, drama Sipas formës: prozë dhe poezi Sipas autorësisë: letërsi artistike, letërsi popullore (letërsi, tekst, gjuhë letrare, lirikë, epikë, dramë, poezi, prozë, letërsi artistike, letërsi popullore)</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Shpjegon domethënien e nocionit/konceptit letërsi. • Shpjegon ndarjet e letërsisë nëpërmjet shembujve përkatës. • Tregon karakteristikat themelore të gjinive letrare duke përdorur shembuj. • Bën dallimin e letërsisë së shkruar në varg dhe letërsisë së shkruar në prozë. • Shpjegon në çfarë forme mund të shkruhen tekstet letrare të çdo gjinie letrare. • Përcakton cilës gjini letrare i takon një tekst i caktuar letrar sipas veçorive të brendshme dhe sipas formës. • Shpjegon kriterin e ndarjes së letërsisë popullore me atë artistike.
<p>Lirika</p> <ul style="list-style-type: none"> • Veçoritë strukturore të poezisë (vargu, strofa, subjekti lirik, motivi, imazhi poetik, vargu i lidhur, vargu i lirë, njëvargëshi, dyvarëgëshi, trevargëshi, katërvargëshi) • Analizë e këngëve lirike sipas motivit dhe shprehjes stilistike (poezi e peizazhit, poezi patriotike; rima, onomatopeja, epiteti, krahasimi, personifikimi) 	<ul style="list-style-type: none"> • Dallon autorin dhe subjektin lirik në poezi të dhëna lirike. • Dallon vargun e lidhur dhe atë të lirë në poezi të dhëna lirike. • Përcakton llojin e strofave të dhëna sipas numrit të vargjeve . • Bën analizë strukturore të poezisë së caktuar lirike dhe përcakton motivin e poezisë. • Identifikon imazhet poetike në një poezi të dhënë lirike dhe i mbështet ato me vargje nga poezia. • Dallon poezinë e peizazhit dhe poezinë patriotike. • Tregon figura stilistike (rima, onomatopeja, epiteti, krahasimi, personifikimi) dhe i ilustron ato me shembuj. • Njeh dhe emërton figura stilistike në poezi lirike.
<p>Epika në prozë</p> <ul style="list-style-type: none"> • Elemente strukturore të tekstit në prozë 	<ul style="list-style-type: none"> • Bën dallimin mes rrëfyesit/narratorit dhe autorit/shkrimtarit të një vepre të caktuar në prozë.

(rrëfyes, ligjërimi i rrëfyesit, narracioni, tema, motivi, personazhi, koha, vendi, ideja)

- Miti
- Përralla
(përrallë, elementet fantastike, tregim realist)
- Tregimi realist
- Tregim i shkurtër
- Romani aventuresk

- Bën dallimin e rrëfyesit/narratorit në vetë të parë (unë) dhe rrëfyesit/narratorit në vetë të tretë (ai).
- Tregon elementet e një teksti në prozë.
- Përshkruan veçoritë e mitit.
- Përcakton karakteristikat e një miti të dhënë.
- Dallon fjalët kyçe dhe fjalët e panjohura në një mit të caktuar dhe mban shënime të shkurtra.
- Jep shembuj mitesh.
- Shpjegon elementet e përrallës (tema, personazhet, koha, vendi, elementet fantastike).
- Përcakton elementet në një përrallë të caktuar.
- Dallon fjalët kyçe dhe fjalët e panjohura në një përrallë të caktuar dhe mban shënime të shkurtra.
- Bën krahasimin mes miteve dhe përrallave sipas veçorive të tyre.
- Jep shembuj të përrallave popullore dhe përrallave me autor.
- Shpjegon elementet e tregimit realist (temë nga përditshmëria, personazhe reale, kohë dhe hapësirë konkrete).
- Zbulon dhe shpreh veçoritë në një tregim të caktuar realist.
- Jep shembuj të tregimeve realiste.
- Shpjegon dallimin në mes të tregimeve realiste dhe përrallave.
- Tregon karakteristikat e tregimit të cilat e dallojnë nga veprat e tjera epike në prozë.
- Zbulon dhe përshkruan elementet në një tregim të shkurtër (rrëfyesin/narratorin, personazhet, përmbajtjen, temën, kohën, vendin, idenë).
- Dallon fjalët kyçe dhe fjalët e panjohura në një tregim të shkurtër dhe mban shënime të shkurtra.
- Tregon karakteristikat e romanit aventuresk të cilat e dallojnë nga veprat e tjera epike në prozë.
- Zbulon dhe përshkruan elementet në një roman të caktuar aventuresk (rrëfyesin/narratorin, personazhet, përmbajtjen, temën, kohën, vendin, idenë).
- Bën lidhjen e ngjarjes të një teksti të caktuar letrar me ngjarjet që ndodhin në realitet duke dhënë shembuj nga jeta e përditëshme.

<p>Drama</p> <ul style="list-style-type: none"> Llojet e dramës (drama, komedia, tragjedia) 	<ul style="list-style-type: none"> Tregon specifikën e tekstit dramatik në raport me lirikën dhe epikën. Dallon veçoritë e llojeve të ndryshme të dramës.
<p>Të shprehurit dhe krijimtaria</p> <p>Tregimi dhe ritregimi (tregimi, romani, filmi, ngjarja)</p> <ul style="list-style-type: none"> Përshkrimi (personazh, objekt, dukuri, peizazh, ngjarje) Shkruarja e teksteve në mënyrë të pavarur (kompozicioni: hyrja, zhvillimi, mbyllja; të shkruarit krijues, ditari) 	<ul style="list-style-type: none"> Ritregon përmbajtjen e një tregimi dhe romani të lexuar (me gojë dhe me shkrim), duke respektuar radhitjen e ngjarjeve në tekst. Ritregon përmbajtjen e një filmi të shikuar (me gojë dhe me shkrim), duke respektuar radhitjen e ngjarjeve në film. Tregon për një ngjarje të përjetuar ose të imagjinuar. Përshkruan personazhe, persona, objekte, dukuri, peizazhe nga jeta reale ose nga ilustrimet/incizimet. Përdor përshkrimin kur përpilon një tekst në mënyrë të pavarur. Shkruan tekst për një temë të dhënë dhe për temë sipas dëshirës, duke i respektuar rregullat e kompozicionit të tekstit. Shkruan në mënyrë të pavarur një tregim të shkurtër të imagjinuar me personazhe dhe ngjarje të dallueshme qartësisht. Tregon një përjetim personal dhe i përshkruan ndjenjat nga përjetimi në formë të një ditari. Respekton rregullat e drejtshkrimit gjatë përpilimit të një teksti.
<p>Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):</p> <p><i>(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. U jepet një fletë pune e cila përmban dy tekste. Njëri tekst është me temë nga enciklopedia apo nga libri i gjeografisë (p.sh. shpjegimi shkencor i diellit), ndërsa teksti i dytë është tekst letrar – poezi (p.sh. "Kur lind dielli " nga Nehat Jahiu). Nxënësit i lexojnë të dy tekstet dhe më pas hapet diskutim për gjuhën dhe përmbajtjen e teksteve të lexuara. Mësimdhënësi/ja, i shënon në dërrasë të zezë kahjet e diskutimit: <i>Si i përjetuat tekstet që lexuat? Cilat janë pikëpamjet tuaja të para? Me çfarë gjuhe janë shkruar dy tekstet? A shpjegohen në mënyrë të njëjtë, nëpërmjet të fjalëve të përdorura, gjërat e paraqitura? A flasin për gjëra të njëjta? A janë të saktë në mënyrë të barabartë të dy tekstet? Çfarë informatash përmban njëri dhe çfarë teksti tjetër? Si paraqitet dielli në këtë poezi? Në cilin nga dy tekstet është përdorur gjuhë jo e zakonshme gjatë përshkrimit të diellit? Në cilin nga dy tekstet gjen shprehje bukuri e fjalës? Për cilin nga tekstet erdhëm në përfundim se është tekst letrar? Pas diskutimeve, në dërrasë të zezë shkruhet një përfundim për nocionin/konceptin letërsi.</i> 	

- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Nëpërmjet një prezantimi ata njoftohen me ndarjen e letërsisë sipas formës, autorsisë dhe vetive të brendshme (gjinisë) dhe karakteristikave të tyre themelore, duke dhënë shembuj përkatës. Të ndarë në grupe me ndihmën e teknikës “*Harta e të menduarit*” e paraqesin ndarjen e letërsisë.
- Nxënësve u jepen fletë pune të cilat përmbajnë poezi, tregime, tekste drame. Gati të gjithë fletët janë të ndryshme. Nën çdo tekst ka hapsirë me vija të zbrazura ku nxënësi/ja do të shkruajë atë që e kupton nga fleta që i është dhënë: *Si është shkruar teksti? Në cilën formë? Çfarë tregon/shpreh/paraqet teksti?* Ndërkohë mësimdhënësi/ja në dërrasë të zezë përgatit një paraqitje skematike dhe një shpjegim të shkurtër për gjinitë letrare (lirikën, epikën, dramën). Nxënësit në letër ngjitëse e shkruajnë titullin e tekstit që e kanë lexuar dhe e vendosin në atë pjesë të paraqitjes skematike ku mendojnë se përket. Diskutohet për zgjedhjen/përgjigjen që e kanë dhënë dhe arsyet e zgjedhjes së tyre. Nga diskutimet do të dalin përfundime, me të cilat do të plotësohet paraqitja skematike.
- Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grupi i jepet fletë pune me dy tekste: njëri në vargje, ndërsa tjetri në prozë. Nxënësit i lexojnë, i shqyrtojnë dhe i krahasojnë tekstet. Viojnë pyetjet nga ana e mësimdhënësit: *A dallohen tekstet nga ana e jashtme (vizuale)? Cili nga dy tekstet është më i afërt me të folurit e përditshëm? Cili nga dy tekstet ka ritmikë më të madhe?* Nxënësit e grupeve shkruajnë në fletëza çka është poezia dhe çka është proza. Grupet i shkëmbejnë fletëzat, kontrollojnë çfarë është shkruar dhe plotësojnë në rast se diçka është harruar nga grupi paraprak. Në çifte përgatisin diagramin e Venit për letërsinë e shkruar në vargje dhe letërsinë e shkruar në prozë.
- Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grupi i jepet tri karta. Grupet kanë për detyrë të hulumtojnë në tekstin mësimor (ose në materialin që e kanë në këndin e librisë së shkollës) dhe të shkruajnë tituj tekstesh dhe autorë. Në kartat shpjegojnë në çfarë forme mund të shkruhen tekstet letrare të çdo gjinie letrare. Secili nga grupet prezanton, duke dhënë shpjegimin përkatës për tekstet e përzgjedhura. Me komente nga nxënësit dhe mësimdhënësi/ja kontrollohet saktësia e detyrës.
- Nxënësit janë të ndarë në tri grupe dhe secilit grup i jepet tekste të ndryshme. Grupit të parë i jepet tekst i shkruar në poezi dhe në prozë, grupit të dytë i jepet një këngë popullore dhe një poezi artistike dhe grupit të tretë i jepet një tekst lirik, epik dhe dramatik. Grupet i lexojnë tekstet dhe përcaktojnë se cilës gjini letrare i përket teksti. Më pas prezantojnë duke dhënë shpjegimin përkatës mbi përkatësinë e tekstit.
- Nxënësit në fletën e punës lexojnë poezi popullore dhe poezi artistike. Bëjnë krahasimin e poezive dhe diskutojnë për autorësinë e tyre, duke vënë në dukje anonimitetin kundrejt autorit konkret.
- Nxënësit lexojnë poezi (shembull, “*Fjalët e qiririt*” nga Naim Frashëri). Diskutojnë në grupe: *Sa e gjatë është poezia? A mund të rrëfëhet poezia? A shprehen ndjenja dhe disponim në të? Si janë ato? Dalloni foljet dhe përemrat në poezi! Në cilën vetë janë foljet në poezi? Edhe kur foljet janë në vetën e parë, a do të thotë kjo që poeti shkruan për veten e tij dhe se ai është qiriri?* Nxënësit i prezantojnë përgjigjet dhe e plotësojnë njëri-tjetrin. Kështu vijnë në përfundim që poeti nuk është qiriri nga poezia, por “*zëri*” i cili shpreh ndjenjat dhe mendimet dhe ai emërtohet subjekt lirik. Individualisht e bëjnë “*Hartën e mendimeve/Paraqitjen skeletore*” për poezinë lirike.

- Nxënësit punojnë në çifte ose në grupe. U jepen dy poezi. Njëra poezi (p.sh. *“Molla e bregut”* nga Azem Shkrel) është me vargje të rimuara (të lidhura), kurse poezia tjetër (p.sh. *“Hapma derën zonja mëmë”* nga Vorea Ujko) është pa vargje të rimuar (me varg të lirë). Nxënësit kanë për detyrë t’i lexojnë poezitë dhe të gjejnë vargjet ku ka rimë dhe ato ku nuk ka rimë. I shkruajnë në fletore dhe i prezantojnë. Më pas kanë për detyrë nga teksti mësimor (ose nga ndonjë material tjetër poetik që e kanë në librarinë e klasës/shkollës) dhe nga poezitë e tjera të paraqesin nga një shembull për vargje të rimuara (të lidhura) dhe nga një shembull për vargje të lira.
- Nxënësit janë të ndarë në grupe. Çdo grupi i jepet fletë pune me strofa të ndryshme të krijuara nga numër i ndryshëm vargjesh. Lexojnë strofat dhe konstatojnë se disa përbëhen nga një, nga dy, nga tri, nga katër apo më shumë vargje. Mësimdhënësi/ja i inkurajon të mendojnë se si quhen strofat. Fillohet nga njëvargëshi, dyvargëshi, trivargëshi, katëvargëshi e deri te dhjetëvargëshi. Aktivitetet mbaron me lojën *Numëro, thekso saktë dhe fito* – garë ndërmjet nxënësve, cili do t’i thotë më shpejt dhe më saktë llojet e strofave.
- Nxënësit nëpërmes teknikës *“Stuhi idesh”* tregojnë në çka i përkujton nocioni *mëmëdhe* i shënuar në dërrasë të zezë. Për shembull, *mëmëdheu – vendi i lindjes, atdhe, krahinë e lindjes, Maqedonia e Veriut, e kaluar, histori e pasur, bukuri natyrore, hero etj.* Nxënësit lexojnë poezinë (shembull, *“Mëmëdheu”* nga Andon Zako Çajup). Poezia interpretohet: *Çfarë ndjenjash tregohen në të? Si i është kënduar atdheut? Cili peizazh poetik ju ka lënë më tepër përshtypje? Pse?* Nxënësit tregojnë mendimet dhe komentet e tyre në lidhje me nocionin motiv ku mësimdhënësi/ja tregon se si ndahen poezitë lirike sipas motivit dhe vijnë në përfundim se çka është poezia patriotike. Dallojnë veçoritë e poezisë patriotike dhe nxjerrin përfundimet sëbashku.
- Nxënësit shikojnë vizatime të peizazheve të cilat i kanë vizatuar vetë apo ua ka dhënë mësimdhënësi/ja. Lexojnë poezinë (*“Zemra e liqerit”* nga Lazgush Poradec) dhe punojnë në grupe me anë të teknikës *Ditar me shënim të dyfishtë*, me qëllim që të shpjegojnë veçoritë themelore të poezive të peizazhit (përshkruese), duke i mbështetur me citate përkatëse. Grupet i prezantojnë përgjigjet.
- Nxënësit lexojnë në mënyrë individuale një poezi (shembull *“Fshati im”* nga Andon Z.Çajupi) e cila është e pasur me imazhe poetike. Pastaj nxënësit ndahen në grupe dhe secilit grup i ndahen strofa të ndryshme nga poezia. Grupet duhet të bëjnë identifikimin e imazheve poetike dhe t’i përshkruajnë ato, pastaj të analizojnë dhe të interpretojnë se çka paraqitet përmes tyre. Grupet prezantojnë dhe plotësojnë njëri-tjetrin dhe pastaj imazhet poetike nga e gjithë poezia i shënojnë në formë të tregimeve të shkurtra.
- Nxënësit renditen në dy radhë. Loja realizohet në çifte. Një nxënës/e imiton një zë, zhurmë ose ton, ndërsa nxënësi/ja tjetër duhet të gjejë se cila kafshë, objekt apo fenomen lëshon zë të tillë. Pastaj lexohet një poezi që përmban onomatope (ose fragment nga *“Gjahu i malësorëve”* të Kostadin Kristoforidhit). Bisedohet për poezinë (fragmentin), caktohet, motivi, vargu, strofa, mesazhi dhe pastaj indentifikohen fjalët që përmbajnë onomatope. U jepet detyrë që nga zëra të caktuar të krijojnë fjalë *onomatope* (p.sh. ciu-ciu, tak-tak, bum-bum etj.)
- Disa nxënës tregojnë emra që u kujtohen në moment dhe i shënojnë në dërrasë të zezë. Pastaj, të ndarë në grupe emrave u vënë mbiemra që do t’i cilësojnë ato. Mundësisht emrave t’u vihen më shumë mbiemra. Mësimdhënësi/ja shpjegon se në veprat letrare mbiemrat kanë funksion ta cilësojnë

ose t'i japin bukuri artistike fjalës dhe t'ia pasurojë kuptimin asaj, përkatësisht sa më e pazakontë të jetë lidhja mes emrit dhe mbiemrit, sa më shumë të shprehë shmangje nga kuptimi i zakonshëm, aq më i arrirë është epiteti. Lexohet poezia (shembull, "Anës Lumenjve" nga F. S. Noli). Nxënësit në grupe, i gjejnë fjalët që emrave ju japin kuptime të reja dhe të pazakonta. Në fund i prezantojnë dhe e shpjegojnë nocionin *epitet*.

- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. U jepet një poezi në të cilën ka krahasime dhe në të cilën çdo *si*, *ashtu si*, *porsi*, *etj.* është shënuar/nënvizuar. Diskutohet për shprehjet e lidhura me *si*, *ashtu si*, *porsi*, *etj.* Konstatimet për figurën stilistike të *krahasimit* shënohen në fletore.
- Nxënësve u jepen karta me fjalë (emra dhe folje). Duke punuar në grupe duhet t'i lidhin emrat me foljet që të fitojnë shprehje të pazakonta. Për shembull e lidhin emrin *re* me foljen *qan* dhe ashtu e fitojnë shprehjen *Reja qan*. Pastaj lexohet poezia (shembull, "Dimni" nga Ndre Mjeda). Poezia Interpretohet sipas nocioneve të mësuara nga fusha e teorisë së letërsisë. Duke punuar në grupe nxënësit i gjejnë vargjet në të cilat dimri paraqitet si krijesë e gjallë, përkatësisht vargjet në të cilat dimrit i jepen veti të njeriut dhe në këtë mënyrë përkufizohet nocioni *personifikim*.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. U jepet për lexim një tregim apo pjesë e një romani në të cilin personazhi rrëfimtari/narratori është një kafshë, bimë apo objekt. Paraprakisht nxënësit marrin të dhëna nga mësimdhënësi/ja për autorin e tregimit. Nxënësit vënë re se rrëfimtari/narratori dhe autori nuk është i njëjti dhe se në çdo tregim ka personazh që është rrëfimtari/narratori dhe se vetem ndonjëherë rrëfimtari/narratori është vetë autori.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet një tregim i shkurtër që është shkruar në vetën e tretë. Në tregim ka disa personazhe. Detyra e nxënësve është të zgjedhin se cilin personazh do ta përfaqësojnë dhe nga pozita e tij ta rrëfejnë tregimin (në vetën e parë). Lexohet ajo që është shkruar dhe diskutohet për narracionin/rrëfimin dhe dallimet e tij në raport me narracionin/rrëfimin i cili në një tekst mund të jetë në formën *unë* apo *ai*.
- Nxënësit ndahen në grupe. Çdo grupi i jepet një fletë pune në të cilën ka: tregim, fragment tregimi ose fragment romani. Në fletën e punës janë dhënë pyetje në lidhje me atë nëse teksti shpjegon, përfaqëson apo shpreh diçka. Nxënësit japin përgjigje dhe pastaj para klasës e lexojnë atë bashkë me fragmentin nga fleta e punës. Hapet diskutim për karakteristikat e prozës (rrëfimi, përshkrimet, ngjarjet, personazhet, gjatësia e tregimit). Në orën e ardhshme nxënësit i rilexojnë tekstet dhe në çdo paragraf veçmas zgjedhin nga një fjalë kyçe, të rëndësishme për ta dhe shpjegojnë se pse e kanë zgjedhur atë fjalë dhe çfarë kuptimi për ta ka ajo në tekst.
- Nxënësit lexojnë në mënyrë individuale një mit kosmogonik për dukurinë se si është krijuar bota dhe gjithësia. Mësimdhënësi/ja ka përgatitur pyetje për mitin (*Për çka bëhet fjalë në këtë mit? Çfarë informata jep miti? Në cilën kohë ndodh? Kush e rrëfen ngjarjen*). Nxënësit përgjigjen në mënyrë individuale në fletore dhe pastaj diskutohet çdo pyetje dhe përgjigje në mënyrë që të nxirret një përfundim i përbashkët se çka përshkruhet në mit.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale, lexojnë pjesë nga "Mitet më të bukura nga antikiteti" nga G. Shvab (zgjidhet një nga mitet: "Miti për Prometeun", "Miti për Ikarin", "Molla e Artë" etj.). Gjatë leximit ata ndajnë fjalë kyçe dhe fjalë të panjohura dhe mbajnë shënime të shkurtra. Në fund nxënësit kanë detyrë me teknikën *Dollapi i leximit* të ritregojnë mitin që e kanë zgjedhur dhe ta vizatojnë personazhin për të cilin bëhet fjalë.

Dollapi i leximit realizohet me një fletë që paloset në katër pjesë, në mënyrë që të fitohen dy dyer të dollapit. Në faqen e jashtme të dyerve vizatohet personazhi ndërsa në pjesën e brendshme ritregohet miti. Prezantohet para klasës.

- Nxënësit në grupe ilustrojnë personazhe nga mitet e lexuara. Çdo grup e prezanton ilustrimin e vet dhe tregon cilit mit të lexuar i referohet ilustrimi.
- Në orën mësimore lexohet *“Përalla”* nga Vëllezërit Grim. Nxënësve u jepen udhëzime si ta analizojnë tregimin fantastik. Me ndihmën e mësimdhënësit/es shënojnë: temën, kohën, vendin, personazhet, përkatësisht heroin, çfarë kërkon apo kë kërkon heroi, kush dhe si e ndihmon ose e pengon heroin, si dhe formulat e fjalëve dhe objektet magjike të cilat i përdor heroi. Prezantimi bëhet para të gjithëve në klasë.
- Nxënësit kanë detyrë të vizatojnë diçka fantastike dhe ta përshkruajnë atë përpara klasës, cili është funksioni i tij dhe kujt do të kishte mundur t’i ndihmojë. Nxënësit të cilët kanë frymëzim mund të trillojnë ndonjë formulë fjalësh dhe ta lexojnë përpara të tjerëve.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale dhe e lexojnë *“Princi i lumtur”* nga Oskar Uajlld. E bëjnë planin e ngjarjeve në tekst dhe bisedojnë për rrëfyesin/narratorin, për përmbajtjen e tekstit, cilat personazhe dhe cilat ngjarje janë fantastike në këtë tekst. Pastaj nxënësve u jepet detyrë të bëjnë një hartë të qytetit ku do t’i shënojnë vendet ku ndodhen personazhet të cilët i ndihmon Princi me ndihmën e dallëndyshes. Në hartë duhet të jetë e vizatuar edhe statuja e princit. Nxënësit duhet t’i emërtojnë edhe rrugët (duhet të kenë kujdes ndaj rregullave për shkrimin e shkronjës së madhe). Mandej zgjedhin një personazh (epizodik, nga ata që morën ndihmë nga Princi) dhe e rrëfejnë tregimin e tij. Të gjitha tregimet e rrëfyera shkruhen shkurtimisht dhe vendosen në klasë.
- Nxënësit bëjnë detyrë-projekt – *Ditët e përrallës*. Në fillim të aktivitetit përgatisin një fjalim dhe prezantojnë ndonjë përrallë të cilin e duan shumë. Pastaj ndahen në grupe dhe u jepet nga një përrallë e re për ta lexuar, çdo orë mësimore, disa orë me radhë. Për realizimin e kësaj mund të përdoren: *“Princesha në një bizele”* nga Andersen, *“ E bija e Hënës dhe Diellit ”* nga M .Kuteli, *“Princi i vogël”* Antuan de Sent Ekzyperi. Nxënësit së bashku i shpjegojnë karakteristikat e përrallës nëpërmjet diskutimit për temën, personazhet dhe për karakteristikat e tyre dhe për ngjarjet fantastike. Çdo grup lexon dhe mban shënime dhe për fjalët kyçe. Shënimet ndahen brenda grupit dhe pastaj ndahen edhe me klasën.
- Nxënësit punojnë në çifte. Përkujtojnë ndonjë mit ose përrallë të lexuar nga orët e kaluara. Me ndihmën e diagramit të Venit i krahasojnë karakteristikat e mitit dhe të përrallës sipas ngjarjeve dhe personazheve.
- Nxënësit punojnë në çifte. Çdo çift ka për detyrë të tregojë disa shembuj të përrallave me autor të njohur dhe të përrallave popullore. Nxënësit i ndajnë shembujt me njëri-tjetrin në klasë.
- Nxënësit ndahen në dy grupe. (Lexojnë *“Rrobat e reja të mbretit”* nga Andersen dhe *“Besa e Konstadinit”* nga Mitrush Kuteli). Bëjnë analizë të përrallave me teknikën *Dritare*. Vizatojnë një dritare dhe në njërin krah të dritares i shënojnë karakteristikat e përrallës, ndërsa në krahun tjetër e vizatojnë parafytyrimin e tyre për përrallën. Pastaj punën e tyre e prezantojnë para klasës dhe i shqyrtojnë temën, personazhet dhe ngjarjet në raport me realitetin.

- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet nga një përrallë. Njërit grup i jepet një tregim realist, ndërsa tjerit në tregim fantastike. Një nxënës/e lexon me zë në kuadër të grupit dhe pastaj të gjithë së bashku i shënojnë karakteristikat e tregimit sipas udhëzimeve të dhëna. Pastaj grupi i cili ka pasur tregimin realist, e merr tregimin fantastik dhe anasjelltas. Kështu të dy grupet i zgjidhin detyrat e njëjtat. Pastaj bëjnë një T-tabelë në të cilën i krahasojnë të dy tregimet. Secili grup e prezanton punimin e vet duke dhënë shembuj edhe për tregime të tjera realiste dhe fantastike.
- Nxënësit në mënyrë të pavarur lexojnë një tregim (shembull, “*Humbja e Luanëve*” nga Jozef Roni) dhe i analizojnë personazhët, cilët janë, sa janë në numër, çfarë veprimesh bëjnë, cilat dhe sa ngjarje përshkruhen, kush tregon (ngjarjen), ku zhvillohet ngjarja. Të lexuarit paraqitet nëpërmjet teknikës *Ylli i tregimit*.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secili grup ka për detyrë të lexojë tregimin e dhënë dhe të dallojë fjalët kyçe dhe të panjohura. Më pas grupet marrin nga tri karta në të cilat duhet të bëjnë shënime të shkurtra në lidhje me fjalët e theksuara. Kartat prezantohen para nxënësve në klasë dhe bisedohet për të njëjtat.
- Nxënësit e fillojnë detyrë-projektin: *Ditët e romanit*. Ndahen në grupe. Brenda tri javëve në disa orë mësimore radhazi, nxënësit lexojnë fragmente romani. Në kuadër të grupit, secili nxënës mban një ditar për leximin e romaneve ose të fragmenteve të romaneve dhe në të i shënon elementet e romanit. Pas çdo leximi të fragmenteve të reja, nxënësit si grup bëjnë një prezantim të asaj që kanë lexuar duke i përdorur shënimet. Për lexim mund të përdoren fragmente të përshtatshme prej romaneve: “*Aventurat e Tom Sojerit*” nga M. Tueni dhe “*Fëmijët nga rruga Pal*” nga F. Molnar.
- Nxënësit sjellin materialin e nevojshëm për të analizuar romanin aventuresk “*Robinson Kruzo*” duke përdorur teknikën *Lektyra në strajcë*. Ndahen në grupe. Çdo grup ka sjellë në klasë nga një qese letre (qese dhurate) dhe disa fletë me ngjyra. Në njërin anë të qeses nxënësit ngjisin një fletë letre ku e ritregojnë shkurtimisht përmbajtjen e romanit. Në anën tjetër të qeses ata ngjisin një fletë tjetër letre ku e shkruajnë temën, idenë, personazhet, autorin, rrëfyesin/narratorin, kohën, vendin. Brenda në qese nxënësit vendosin pesë fletë të vogla ku përshkruajnë shkurtimisht pesë aventura të Robinson Kruzosë. I këmbëjnë qeset mes vete dhe lexojnë çfarë kanë shkruan.
- Secilit nxënës i jepet një fletë punë në të cilën janë shkruar: një poezi, një tregim dhe fragment i një drame. Nxënësit në fund të secilit shembull shkruajnë llojin e gjinisë letrare. Së bashku me mësimdhënësin/en diskutojnë për specifikat e secilës gjini letrare.
- Nxënësit në fletore, me fjalët e tyre i shkruajnë veçoritë e llojeve të dramës: të tragjedisë dhe të komedisë. Pasi disa prej tyre e lexojnë para të tjerëve detyrën e dhënë, mësimdhënësi/ja jep mendim dhe vlerësim për secilin prej tyre.
- Nxënësit zgjedhin një personazh (më parë mësimdhënësi/ja ka përgatitur për ta vizatime prej kartoni me foto profili të një personazhi nga një roman i lexuar, fytyra e të cilit është prerë, kështu që nxënësi aty vendos fytyrën e vet). Atyre u jepet detyra të vendosin veten në pozicionin e personazhit që kanë zgjedhur dhe të rrëfejnë gojariht një nga ngjarjet e tij dhe më pas rrëfejnë një ngjarje të tyre ose që e kanë parë në jetën e përditshme. Më pas klasa diskuton ngjashmëritë mes problemeve të personazheve dhe të nxënësve.

- Nxënësit punojnë në klasë një lektyrë - roman. Mësimdhënësi/ja i ka shënuar në dërrasë të zezë titujt e kapitujve ose ka paraqitur një ndarje tjetër të strukturës së romanit, për t'ua dhënë një orientim në ritregimin e asaj që kanë lexuar, përkatësisht në radhitjen e ngjarjeve. Nxënësit ndjekin dhe plotësojnë njëri-tjetrin gjatë ritregimit të romanit.
- Nxënësit shikojnë një film në klasë (ose kanë qenë në kinema më parë). Pasi ta kenë parë filmin, nxënësit kanë për detyrë ta ritregojnë filmin, duke respektuar rendin e ngjarjeve në film.
- Nxënësit punojnë me teknikën *Imagjinatë e orientuar*. Ata i mbyllin sytë dhe i dëgjojnë udhëzimet: *Imagjinojeni veten pranë një bregu të bukur me diell. Po ecni buzë detit dhe po merrni frymë thellë duke e thithur ajrin e pastër të mëngjesit. Po e nuhasni kripën e detit. Po e dëgjoni spërkatjen dhe valët. Gjithçka është e qetë. Nuk ka njeri në breg. Qielli është i kaltër. Nga larg shihen zogjtë e bukur që këndojnë me gëzim dhe fluturojnë në rrathë. Papritur, në largësi shihni një varkë. Në të ndodhet dikush që ju e doni shumë. Ai/ajo i afrohet bregut dhe jua bën me dorë. Po ju thërret. Ju fton të hipni në varkë dhe lundroni në gjerësisë e detit. Ju gëzoheni. Duke qenë të gatshëm, me rroba banje, vrapon drejt detit. E ndieni se uji është i ftohtë, por kjo nuk ju pengon. Ju freskon. I dëgjoni spërkatjet tuaja në ujë. Ju notoni deri te njeriu. Ai jua jep dorën dhe ju hipni në varkë. Ndiheni mrekullueshëm. Është qetë, deti është i kaltër dhe valëzon butësisht. Zogjtë tani janë më afër jush. I dëgjoni mirë si këndojnë. Heshtni dhe e shikoni qiellin e kaltër pa asnjë re. Spërkatja e valëve dëgjohet në varkë... zgjoheni... Pasi "të zgjohen", nxënësit u përgjigjen pyetjeve: Si ishte qielli? Si dukej personi që e doni? Kush është ajo/ai? A mbante kapelë? Çfarë ngjyre ishte? Çfarë po dëgjonit? Çfarë patë? Pasi të përfundojë diskutimi i shkurtër gjatë së cilit nxënësit tregojnë çfarë kanë parë dhe dëgjuar, nxënësit të gjitha i shkruajnë në formë të një tregimi të shkurtër.*
- Në klasë, nxënësit flasin për një person të famshëm që mund të jetë një yll muzike, sportist apo aktivist. Më pas lexohet një tekst në të cilin përshkruhet personi, paraqiten fakte dhe informacione. Pastaj nxënësit vazhdojnë me punë individuale dhe e përshkruajnë personin me shkrim. Në fund i lexojnë tekstet dhe e diskutojnë përmbajtjen e përshkrimit.
- Nxënësit ndahen në çifte. Për detyrë kanë që në fletore të emërtojnë një fenomen natyror: breshër, borë, bubullimë, tornado, tërmet... dhe më pas, duke përdorur teknikën *Stuhi idesh*, t'i shkruajnë të gjitha fjalët që u kujtohen kur mendojnë për atë fenomen. Duke përdorur këto fjalë, nxënësit bëjnë një përshkrim të fenomenit që e kanë emërtuar.
- Nxënësit zgjedhin stinën e tyre të preferuar dhe i shënojnë në fletoret veçoritë e saj. Bëjnë një vizatim të pranverës, të verës, të vjeshtës ose të dimrit dhe e përshkruajnë me gojë. Pastaj nxënësve u jepet një kartë ku bëhet përshkrimi i një personazhi. Për detyrë kanë ta fusin personazhin në një histori të imagjinuar që e përshkruan stinën e zgjedhur. Personazhi nuk e pëlqen / e do atë stinë. Atë që kanë shkruar, e ndajnë me nxënësit e tjerë në klasë.
- Nxënësve u jepet detyrë të përshkruajnë personazhe, persona, objekte, dukuri, peizazhe nga jeta reale ose nga ilustrime/ incizime të caktuara.
- Nxënësit ndahen në grupe. Secilit grup i jepet nga një fragment prej librit "*Tregime për djem që guxojnë të jenë ndryshe*" nga Ben Brooks. Personin që kanë në fragment, ata më pas e përshkruajnë dhe e portretizojnë në një tekst të shkurtër. Ato që kanë shkruar e ndajnë me të tjerët në klasë. Në

fund, ata zhvillojnë një bisedë për burrat e famshëm dhe jo shumë të famshëm të së shkuarës dhe të tashmes që e kanë bërë botën një vend më të mirë përmes dhembshurisë, bujarisë dhe vetëbesimit.

- Nxënësit punojnë në çifte. Me ndihmën e teknikës “*Hamburger*” e përvetësojnë njësinë mësimore Kompozicioni i tekstit. Nxënësve u jepen pjesë hamburgeri të bëra prej letre. Buka e sipërme është hyrja, buka e poshtme është mbyllja. Qoftja është zhvillimi. Perimet janë figurat stilistike dhe patatet e skuqura janë fjalët e sapomësuar. Në anën e pasme të letrave nxënësit i shkruajnë pjesët përkatëse të tekstit dhe pastaj e lexojnë tërë tekstin. Në këtë mënyrë ata e kuptojnë rëndësinë e të gjitha elementeve të tij. Ky aktivitet mund të realizohet edhe me material elektronik: me prezantim, me foto, me forma 3D etj.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. (Ky aktivitet i ndihmon ata të kuptojnë se si krijohen mitet.) Për detyrë kanë të imagjinojnë se janë një fis që jeton i izoluar në një zonë pyjore. Ata jetojnë ashtu siç kanë jetuar fiset indigjene në të kaluarën. Rrjedhimisht, fisi i tyre nuk ka njohuri për të gjitha shpikjet teknike të sotme. Një ditë, një anije kozmike shfaqet nga qielli. Dy qenie, me një shkëlqim të madh, dalin nga anija kozmike... Detyra e nxënësve është që nga pozicioni i njerëzve të asaj kohe të japin një shpjegim si ka ndodhur kjo, kush janë dy qeniet, si do t'i trajtojnë ata... etj. Disa nxënës i tregojnë idetë e tyre dhe mësuesimdhënësi/ja i shkruan ato në dërrasë të zezë (nëpërmjet teknikës *Stuhi idesh*) dhe më pas u kërkon nxënësve të shkruajnë një tekst të shkurtër ku njëra qenie është Zoti i Universit dhe qenia tjetër është Perëndesha e Tokës, gruaja e tij. Tekstet i shkruajnë duke respektuar rregullat e kompozicionit të tekstit (pjesa hyrëse, pjesa kryesore dhe përfundimi). Atë që kanë shkruar, e lexojnë në klasë përpara nxënësve të tjerë.
- Nxënësit punojnë në mënyrë individuale. Për detyrë kanë të mbajnë shënime për një detyrë ose për një projekt që e kanë pasur në lëndën e gjuhë shqipe. Shënimet i shkruajnë në një fletore të veçantë dhe çdo shënim i vënë datë. Nxënësit shënimet mund t'i regjistrojnë edhe në mënyrë elektronike dhe më pas t'i publikojnë në formatin PDF si libër elektronik dhe për për këtë mund të përdorin ndonjë aplikacion nga interneti.
- Nxënësit punojnë në çifte. U jepet një tekst, në të cilin disa fjalë janë shënuar me hijezim. Detyra e tyre është që këto fjalë t'i ndërrojnë me fjalë ose me shprehje të reja dhe kështu do ta pasurojnë tekstin në mënyrë krijuese. Në fund të gjithë së bashku e kontrollojnë tekstin nga pikëpamja e zbatimit të rregullave të drejtshkrimit.

Fusha programore: NJOHURI MEDIATIKE

Gjithsej: 20 orë

Rezultatet e të nxënësve:

Nxënësi/nxënësja do të jetë i/e aftë:

1. të bëjë dallim mes lajmeve dhe opinioneve;
2. të shpjegojë rolin e gazetarisë dhe nevojën për t'iu përmbajtur standardeve etike (paanësia dhe ekuilibri);
3. të shpjegojë rëndësinë e lirisë së shprehjes dhe të respektimit të standardeve etike të sjelljes në mjedisin digjital;

4. të njohë gjuhën e urrejtjes në media dhe t'i tregojë strategjitë për të luftuar gjuhën e urrejtjes.

Nxënësi/ja do të zhvillojë vetëdije për:

5. sjelljen etike në komunikimin online;
6. ndikimin e mesazheve dhe e përmbajtjeve mediatike në opinionin e përdoruesve.

Përmbajtjet (dhe konceptet):	Standardet për vlerësim:
<ul style="list-style-type: none">• Roli i gazetarisë (lajmet, opinionet, gazetar, gazetari, standardet etike, paanësia dhe ekuilibri)	<ul style="list-style-type: none">• Tregon shembuj të përmbajtjeve informative dhe shembuj të përmbajtjeve ku jepen opinione.• Shpjegon rolin e gazetarisë në shoqëri.• Shpjegon rëndësinë e paanësisë dhe të ekuilibrit si standarde etike.
<ul style="list-style-type: none">• Liria e shprehjes dhe sjellja etike në mjedisin digjital (fyerjet dhe shpifjet personale, respektimi i privatësisë)	<ul style="list-style-type: none">• Shpjegon rëndësinë e shprehjes së lirë gjatë krijimit dhe ndarjes së përmbajtjeve mediatike.• Njih fyerjet dhe shpifjet personale në komunikimin <i>online</i>.• Shpjegon (me shembuj) se çfarë do të thotë të mbrosh privatësinë në hapësirën digjitale.• Njih shkeljen e të drejtës së privatësisë në komunikimin <i>online</i>.• Shpjegon pasojat e sjelljes joetike në mjedisin digjital.
<ul style="list-style-type: none">• Stereotipet dhe gjuha e urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale (stereotipet gjinore, stereotipet e moshës, stereotipet racore, stereotipet etnike, stereotipet profesionale, gjuha e urrejtjes)	<ul style="list-style-type: none">• Njih stereotipet në media.• Shpjegon se si stereotipet shtrembërojnë të vërtetën.• Shpjegon pasojat e përhapjes së stereotipeve përmes mediave dhe rrjeteve sociale.• Njih gjuhën e urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale.• Shpjegon se çfarë është gjuha e urrejtjes.• Shpjegon pasojat e përdorimit të gjuhës së urrejtjes në media dhe në rrjetet sociale.• Tregon strategjitë për të luftuar gjuhën e urrejtjes.
Shembuj veprimtarish (aktivitetesh):	
<p><i>(Shembujt kryesisht integrojnë shumë standarde vlerësimi të së njëjtës përmbajtje që mund të realizohen në orë të shumta. Shembujt e dhënë mund të shërbejnë si model për krijimin e aktiviteteve të reja për standardet e njëjta ose për standarde të tjera që nuk janë përfshirë me to.)</i></p> <ul style="list-style-type: none">• Nxënësve, të ndarë në grupe, u jepet një komplet prej 8 karta me tekste të shkurtra publicistike (të trilluara ose të marra) me një autor të emërtuar (i trilluar ose real). Tri nga tekstet duhet të jenë me përmbajtje informative, kurse pesë me përmbajtje ku jepet opinion dhe secili tekst duhet të jetë për temë të ndryshme (p.sh. shëndeti, kultura, sporti, korrupsioni, mbrojtja e mjedisit):	

- Shembuj të teksteve informative: *Rezultatet e çerekfinales së Kampionatit Botëror të Futbollit; Informacion për vendet e lira për regjistrim në shkollat e mesme; Pasqyrë e aksidenteve të trafikut, në të cilat kanë humbur jetën këmbësorët gjatë vitit të kaluar.*
- Shembuj të teksteve ku jepet opinion: *Si të bëhen gratë më të përfaqësuara në qeverisje; Si të ushqehemi në mënyrën e duhur për të qenë të shëndetshëm; Të pastrehët u bënë edhe realiteti ynë; Shkupi sërish ndër qytetet më të ndotura në botë: Çfarë mendojnë qytetarët për këtë?; Kush vuan më shumë nga bullizmi – djemtë apo vajzat?*

Në të njëjtën kohë, duhet pasur kujdes që tekstet të jenë të paanshme/objektive (t'i përjashtojnë paragjykimet e gazetarëve), kurse ato që shprehin opinion të jenë edhe të ekuilibruar (t'i përmbajnë qëndrimet/argumentet e njerëzve me pikëpamje të ndryshme në lidhje me çështjen/problemin).

Grupeve u jepet për detyrë t'i analizojnë tekstet dhe t'i grupojnë ato sipas faktit nëse ato përmbajnë vetëm informacion ose, përveç informacionit përcjellin edhe një opinion (mendim). Pasi të bëjnë prezantimin e përgjigjeve, hapet një diskutim rreth dallimit mes përmbajtjeve informative dhe përmbajtjeve që shprehin opinion. Në bazë të diskutimit, arrihet përfundimi se cilat janë përgjigjet e sakta të pritura (veçanërisht e rëndësishme nëse ndonjë grup nuk i ka ndarë tekstet saktë).

Kartelat e njëjta përdoren për t'u identifikuar autorët e teksteve dhe për të treguar se ata janë gazetarë dhe se tekstet janë artikuj gazetaresk që gjenden ose mund të gjenden në media (elektronike ose të shkruara). Grupeve u jepen nga dy kartela me tekste (kombinime të ndryshme për secilin grup) me detyrë t'i analizojnë ato në aspektin: (1) çfarë informacioni ose problemi përfshijnë, (2) si e ndihmojnë lexuesin ose ndikojnë tek ai, dhe (3) si ato mund të kontribuojnë në jetën e përditshme të njerëzve ose në zgjidhjen e problemeve në shoqëri. Pasi nxënësit do t'i prezantojnë rezultatet e analizës, diskutohet bashkërisht roli i gazetarëve dhe rëndësia e gazetarisë për jetën e përditshme të njerëzve dhe për demokracinë në shoqëri.

Mësimdhënësi/ja përdor një nga tekstet që shprehin opinion për të treguar se çfarë nënkuptohet me raportimin gazetaresk të paanshëm (objektiv) dhe të ekuilibruar. Më pas, secili grup merr një tekst me detyrë për ta kthyer atë në një tekst të njëanshëm dhe të paekuilibruar. Pastaj grupet i lexojnë tekstet "e reja" dhe në fund diskutohet se cilat janë pasojat e raportimit të njëanshëm dhe të paekuilibruar dhe pse është e rëndësishme që të gjithë artikujt gazetaresk të ndjekin kërkesat për raportim të paanshëm dhe të ekuilibruar.

- Nxënësit, të ndarë në grupe, marrin këtë detyrë: Secili nga grupi duhet të imagjinojë se në ndonjë rrjet social (*Facebook, Instagram, Tik-Tok...*) ka publikuar një *selfie*. Në një fletë të përbashkët secili nxënës i grupit shkruan nga një koment që ai/ajo do të dëshironte ta merrte nën *selfie-n* e postuar (p.sh.: *Ti je shumë tërheqëse 😊; Dukesh TOP ♥; Model i vërtetë!; Super tip 🙌*). Më pas fletët vendosen në mur dhe lexohen komentet e të gjithëve. Nxënësit bashkërisht vijnë në përfundim se të gjithë duan të marrin komente pozitive.

Grupeve u jepet detyrë që në një fletë tjetër të shkruajnë komente negative, të cilat nën *selfie-n* e tij/saj do t'i kishin postuar disa të tjerë kur duan ta fyejnë atë (p.sh.: *Dukesh si dinosaur 🦖; Po sikur të kishe humbur ndonjë kile 🙄; Bljak 🤪; Shih si dukesh bre 🤔*). Fletët vendosen në mur dhe lexohen komentet e shkruara. Diskutohet se çfarë ndjenjash shkaktajnë komentet e këtilla të personi, të cilit i thuhet.

Grupeve u jepet për detyrë të imagjinojnë një situatë në të cilën dikush e shkarkon *selfie-n* e publikuar dhe e ndan atë me dikë tjetër dhe nën imazhin e shkarkuar publikon edhe një koment në formën e shpifjes - gënjeshtër për dikë me synim për ta baltosur, për t'ia dëmtuar reputacionin (p.sh.: *Ky është hajduti i garderobave në orët e edukimit fizik; Kampione në puthje*). Në një fletë të veçantë, secili anëtar i grupit shkruan një koment në formë

shpifjeje. Më pas fletët vendosen në mur dhe lexohen komentet e të gjithëve. Të gjithë së bashku i diskutojnë pyetjet: (1) Cilat janë pasojat për personin, për të cilin është shpifur? (2) Si është shkëlur privatësia e tij edhe atëherë kur emri i tij nuk është publikuar? (3) Sa etike është të ofendosh të tjerët dhe të shpifësh për ta përmes rrjeteve sociale? Bashkërisht arrihet në përfundimin se secili ka përgjegjësi të veprave në mënyrë etike njësoj si në realitet - shpifja dhe fyerja në rrjetet sociale është sjellje e dhunshme, edhe pse personi që shpif dhe fyen "nuk shihet".

Secili grup jep propozime për sjellje etike në rrjetet sociale – çfarë duhet, përkatësisht nuk duhet të bëhet (për shembull, *Mos i ofendo dhe nënçmo të tjerët. Mos përdor fjalë fyese dhe të pahijshme kur komenton fotot dhe postimet e të tjerëve. Mos zbuloj informacione private për të tjerët. Mos (shpër)ndaj foto dhe informacione konfidenciale pa leje.*). Nga rekomandimet e dhëna përpilohet bashkërisht një kod i sjelljes në rrjetet sociale.

- Nxënësit, të ndarë në 5 grupe, tërheqin një nga kompletet e kartave në të cilat shkruhet (një nocion në secilën kartelë): RACA (të bardhë, zezakë dhe të tjerë), GJINIA (djalë, vajzë, grua, burrë), PROFESIONI (policë, mjekë, mësues e të tjerë), MOSHA (të moshuar, të rinj, adoleshentë), FAMILJA (bijë, bir, nënë, baba, gjyshe, gjysh). Secili grup, në një fletë të madhe letre, duhet të përshkruajë (me fjalë dhe me një vizatim) se si njerëzit nga karta e zgjedhur janë paraqitur në media (në filma, seriale, reklama) - *si duken, si sillen dhe çfarë cilësish kanë*. Në një fletë tjetër, ata duhet të japin edhe shembuj të mediave ku i kanë parë këto (në cilin film, serial apo reklamë). Pas përfundimit të punës, secili grup (një nga një) i var në mur fletët e veta me përshkrimet e shembujt dhe ua prezanton punën e vet të tjerëve. Pas çdo prezantimi, nxënësit e grupeve të tjera bëjnë plotësime me shembujt e tyre dhe së bashku përfundohet se cili është përshkrimi që dominon në media. Mësimdhënësi/ja i shkruan në tabelë të gjitha përshkrimet e dhëna që përputhen me stereotipet e zakonshme për grupet (p.sh.: *Zeakët janë kriminelë, shesin drogë... Gjyshet janë të kujdesshme, bëjnë byrek, nuk i kushtojnë shumë rëndësi pamjes së vet... Djemtë janë të guximshëm, të fortë, nuk qajnë*).

Mësimdhënësi/ja i përdor përshkrimet e shkruara në tabelë për ta përkufizuar termin *stereotip* (një karakteristikë që u atribuohet anëtarëve të grupeve të caktuara) dhe për t'i treguar llojet e stereotipeve që janë përcaktuar nga grupet të cilave u referohen (stereotipe racore, gjinore, profesionale, të moshës). Në të njëjtën kohë, përshkrimet e anëtarëve të familjes lidhen me stereotipet gjinore dhe të moshës.

Brenda çdo grupi, secili nxënës duhet të japë shembull të një personi konkret që ai e njih, por që është i ndryshëm nga stereotipi dhe t'i tregojë karakteristikat e tij/saj që e bëjnë atë të dallohet (të jetë i ndryshëm) nga stereotipi. Grupet i prezantojnë shembujt e tyre. Në një diskutim të hapur, arrihet në përfundimin se media kryesisht na bën që të gjithë anëtarët e një grupi t'i shohim sikur janë të njëjtë (sipas stereotipit), edhe pse shumë prej tyre ndryshojnë nga stereotipi.

Zhvillohet diskutim i hapur për të shpjeguar se si stereotipet gjinore në media transmetohen edhe në rrjetet sociale: (1) Sa ndihet i lirë dikush (djalë apo vajzë) që është i ndryshëm nga stereotipi të prezantohet në këndvështrimin e duhur?; (2) Si do të reagonin të tjerët në qoftë se ai/ajo paraqitet në një këndvështrim tjetër; (3) Cilat janë pasojat e kësaj? Së bashku konstatohen pasojat negative të përhapjes së stereotipeve gjinore dhe të llojeve të tjera përmes mediave dhe rrjeteve sociale.

Grupeve u kërkohet të përgatisin një paralajmërim që do të vendoset përpara filmit, serialit ose reklamës që nxit stereotipe për një grup të caktuar, sipas parimit të paralajmërimit për cigaren: Duhani vret - të krijojnë një fjali goditëse që tregon për pasojën e pranisë së stereotipit konkret.

GJITHËPËRFSHIRJA, BARAZIA / NDJESHMËRIA GJINORE, INTEGRIMI NDËRKULTUROR DHE NDËRLËNDOR

Mësimdhënësi siguron gjithëpërfshirjen e secilit nxënës në të gjitha aktivitetet që zhvillohen gjatë orës mësimore. Kështu, ai mundëson që çdo fëmijë të angazhohet në mënyrë njohtëse dhe emocionale me anë të qasjeve të duhura metodologjike (individualizim, diferencim, punë në grupe, mbështetjen nga bashkëmoshatarët). Gjatë punës me nxënësit me pengesa në zhvillim zbaton planin arsimor individual (me rezultate të përshtatshme të të nxënësve dhe të standardeve për vlerësim) dhe gjithmonë, kur është e mundur, shfrytëzon mbështetjen nga persona të tjerë (asistentë personalë dhe arsimorë, ndërmjetësues arsimorë, ndërmjetësues arsimor, mësues vullnetarë dhe profesionistë të shkollave me qendra burimore). Përcjell rregullisht të gjithë nxënësit, veçanërisht ata nga grupet e pambrojtura, që të mund t'i identifikojë me kohë vështirësitë e tyre në të mësuar dhe t'i inkurajojë e t'i përkrahë ata në arritjen e rezultateve të të nxënësve.

Gjatë realizimit të aktiviteteve mësimdhënësi trajton njëloj si djemtë, ashtu edhe vajzat, duke u kujdesur që të mos u ndajë atyre role me stereotipa gjinorë. Gjatë formimit të grupeve të punës, mësimdhënësi përpiqet të sigurojë një balancim të bazuar në gjini. Gjatë përzgjedhjes së materialeve shtesë në mësimdhënie, ai përdor ilustrime dhe shembuj të ndjeshëm në pikëpamje gjinore dhe etnike/kulturore, që nxitin barazinë gjinore, përkatësisht që promovojnë interkulturalizmin.

Gjithmonë, kur është e mundur, gjatë planifikimit dhe realizimit të mësimdhënies, mësimdhënësi përdor integrimin e temave / përmbajtjeve / koncepteve. Integrimi ua mundëson nxënësve të përfshijnë këndvështrime nga lëndët e tjera mësimore në atë që mësojnë në lëndën e gjuhës shqipe dhe kështu të ndërlihin njohuritë e fushave të ndryshme në një tërësi.

VLERËSIMI I ARRITJEVE TË NXËNËSVE

Për t'ua mundësuar nxënësve t'i arrijnë standardet e pritura të vlerësimit, mësimdhënësi duhet të bëjë vlerësim të përvojave, njohurive dhe aftësive të mëparshme të nxënësve, të ndjek vazhdimisht aktivitetet e nxënësve gjatë mësimdhënies dhe gjatë të nxënësve duke mbledhur informacione në lidhje me përparimin e secilit nxënës. Për pjesëmarrjen në aktivitete, nxënësit marrin informacione kthyesë të cilat tregojnë nivelin e suksesit gjatë realizimit të aktiviteteve/detyrave dhe japin udhëzime për përmirësim (vlerësimi formativ). Për këtë qëllim, mësimdhënësi përcjell dhe vlerëson:

- përgjigjet me gojë për pyetjet e bëra nga mësimdhënësi ose nga nxënësit e tjerë;
- parashtrimin e pyetjeve dhe pjesëmarrjen në diskutime gjatë orës mësimore;
- detyrat e shtëpisë;
- përgjigjet në kontrolle dijesh (teste të shkurtra) që janë pjesë e mësimdhënies;
- pyetjet ese;
- punimin e projekteve;
- përgatitjen e afisheve/postereve;

- ushtrimet kontrolluese;
- testet e njohurive;
- ditarët refleksiv;
- detyrat dhe veprimtaritë hulumtuese gjatë të cilave nxënësi kryen: mbledhjen e të dhënave, evidentimin, paraqitjen e rezultateve - në mënyrë narrative ose me tabela, me diagrame ose me grafikë dhe të bëjë prezantimin e tyre;
- punimet praktike (p.sh. të shkruarit / krijimi i teksteve sipas kërkesave të ndryshme, analiza dhe interpretimet e teksteve letrare, analiza gramatikore e tekstit, demonstrime, skema, ilustrime, prezantime etj.);
- raporte të shkruara me të dhëna nga hulumtimet e kryera.

Pas përfundimit të secilës temë, nxënësi merr notë sumative në formë përshkrimi sipas standardeve të arritura të vlerësimit. Vlerësimi sumativ kryhet duke kombinuar rezultatin e arritur nga testet e njohurive me vlerësimin e progresit të konstatuar nëpërmjet teknikave të ndryshme të vlerësimit formativ. Në fund të vitit shkollor nxënësi merr notën sumative me numër.

Fillimi i zbatimit të programit mësimor	Viti shkollor 2023/2024	
Institucioni/bartës i programit mësimor	Byroja e Zhvillimit të Arsimit	Биро за развој на образованието
<p>Sipas nenit 30, paragrafi 3 i Ligjit për Arsimin Fillor (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 161/19 dhe 229/20), ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi programin mësimor të lëndës <i>Gjuhë shqipe</i> për klasën VI.</p> <p>Согласно член 30, став 3 од Законот за основно образование („Службен весник на Република Северна Македонија“ бр. 161/19 и 229/20) министерот за образование и наука ја донесе наставната програма по предметот <i>Албански јазик</i> за VI одделение.</p>	<p>nr. _____ viti _____</p> <p>бр. 08-3312/2 17.3.2023 година</p>	<p>Министер за образование и наука, Дос. Dr. Jeton Shaqiri, с.р.</p> <p>_____</p>